



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 18 DHJETOR 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
18. DECEMBRA 2009. GODINE

DHJETOR – DECEMBAR
2009

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Hap punimet e seancës së sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Urdhëro, Ramë Buja!

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Kolegë deputetë,

Unë kam një propozim për pikën e gjashtë, kryetar, që sot të hiqet nga rendi i ditës për një fakt që kjo pikë dhe ky material duhet të kalojë një herë nëpër Komision për Tregti dhe Industri e pastaj të vijë në Kuvend, sepse nuk ka kaluar fare nëpër komision dhe unë e çmoj si diçka që ka kaluar nëpër një shkallë që nuk është dashur të kalohet. Andaj, propozoj që t'i kthehet Komisionit për Tregti e Industri e pastaj t'i vijë Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Komisioni, a ka...? Deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë,
Duke marrë parasysh se Komisioni dhe ju si kryetar i Kuvendit të Kosovës i kemi bërë ftesë shumë herë Qeverisë që t'i bien emrat për Bordin e KPPM-së, atëherë sipas Rregullores së Kuvendit kjo duhet të kalojë një herë nëpërmes komisionit, mandej të dalë në seancë plenare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Do të thotë, kërkesa është të hiqet nga rendi i ditës.

Atëherë, na duhet një votim formal. Kush është "për"? Faleminderit! Kush është "kundër"? Nuk ka. Abstenime? Me shumicë absolute pika e gjashtë e rendit të ditës hiqet nga rendi i ditës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 26 nëntor dhe 4 dhjetor 2009

Pyes, nëse ka dikush vërejtje në procesverbale? Nuk ka. Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 26 nëntor dhe 4 dhjetor 2009.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetjet parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Vazhdojmë procedimin me pyetjen e parë. Deputetja Qamile Morina, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj, ministri nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen, deputete? Regjia, fjalën deputetes Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetjen e kam bërë edhe në seancën e kaluar, kështu që s'ka nevojë të përsëritet, meqë ministri nuk është këtu.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Ligji për letrat me vlerë është me rëndësi të veçantë për sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Mungesa e tij ka shkaktuar vakuum juridik të konsiderueshëm. Duke marrë parasysh faktin se në këtë Kuvend është miratuar në shqyrtim të parë edhe Ligji për borxhet publike, Ligji për letrat me vlerë është më se i domosdoshëm. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji për funksionimin e tregut të lirë të mallrave dhe të shërbimeve, si dhe faktin se në Strategjinë legjislative të Qeverisë së Kosovë është përfshirë ky ligj, për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave bëj këtë pyetje: - Ku qëndron arsyeja e vonësës së procedimit të këtij ligji për miratim në Kuvendin e Kosovës?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputet, Dauti,

Ligji për letrat me vlerë është një nga ligjet mbase shumë të rëndësishëm, jo vetëm për zhvillimin e tregut të kapitalit dhe të rregullimit të sistemit të letrave me vlerë apo të formave, të instrumenteve të tjera të pagesës, por edhe për zhvillimin ekonomik. Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka përgatitur draftin e tij, i cili po thuaj se është final. Nuk e kemi proceduar në Kuvend thjeshtë derisa të aprovohet Ligji për huan publike, gjithnjë duke shpresuar dhe në marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me Bankën Botërore që të sigurohemi se ligji bazik, që është Ligji për huan publike, të jetë i përmbyllur dhe pastaj në bazë që është ligj organik dhe pastaj Ligji për letrat me vlerë të jetë koherent dhe në bashkëveprim me të gjitha trendet më të reja në tregun botëror dhe regional.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e ka grupin punues dhe, siç e thashë, e ka draftin final, ne kemi paraparë që në pjesën fare të parë, pasi që të kemi edhe përfundimet finale të sugjerimeve nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, ta procedojmë këtu në Parlament. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

A e doni fjalën? Regjia, fjalën deputetes Myrvete Pantina!

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të hyrat e deritanishme në Fondin e privatizimit, sipas të dhënave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit kanë kaluar mbi 400 milionë euro. këto mjete janë të investuara në bankat evropiane dhe ende mbeten të pa shfrytëzuara nga ekonomia kosovare. Që nga themelimi i saj, AKP-ja ka marrë vendim për kthimin e këtyre mjeteve në Kosovë, por nga Banka Qendrore e Kosovës ende nuk ka asnjë përgjigje.

Zoti ministër, pse Banka Qendrore e Kosovës nuk ndërmerr masa për kthimin e këtyre mjeteve në Kosovë? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, e nderuara deputete!

Sigurisht, mbase pyetja do të duhej të jetë më shumë e orientuar nga Banka Qendrore, me qenë se ishte pse Banka Qendrore nuk merr masa, por sido që të jetë, është organ i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Por, më lejoni që të sqaroj, si në vazhdim.

Diku vitin e kaluar, më duket, sipas shënimeve që unë i kam, më 22 janar të vitit 2009 Agjencioni Kosovar i Privatizimit i ka dërguar letër Bankës Qendrore të Kosovës që të bëjë kthimin e mjeteve, ndërsa Banka Qendrore e Kosovës, përkatësisht bordi pas shqyrtimit të të gjitha analizave që i ka bërë dhe kompetencave që i ka në funksion e në bazë të gjykrimeve më të mira që ata kanë mund të arrijnë, është se ende po thuaj se e pamundur në aspektin legjislativ që këto mjete të kthehen për funksionim në Kosovë, se janë të ruajtura në Bankën Qendrore të Kosovës. Ndërsa Banka Qendrore e Kosovës, si agjent fiskal, përkatësisht si institucioni i vetëm i autorizuar për menaxhimin dhe investimin e këtyre mjeteve në instrumentet e ndryshme të sigurta në tregjet botërore, në bazë të politikave të veta sigurisht që ka nevojë ende për të përmbyllur ca legjislacione, duke përfshirë edhe Ligjin mbi huat, edhe Ligjin mbi emetimin e parave me vlerë, edhe organizimin e tregut të parave me vlerë, në mënyrë që këto mjete të kthehen. Sigurisht që këto mjete më së shpejti do të mund të ktheheshin përveç për t'u investuar përkohësisht ose në afat të mesëm në qoftë se procesi i likuidimit do të ishte sa më i shpejtë në Agjencionin Kosovar të Privatizimit, gjë e cila fatkeqësisht ka ngecur ende dhe për të cilën besoj që Kuvendi do të duhej të merrte masat e veta konform ligjeve dhe kompetencave që i ka.

Sa di unë, këtu është një përgjegjësi po ashtu e ICO, përkatësisht të Zyrës Ndërkombëtare Civile, e cila ka pasur një vonesë në emërimin e kryetarëve të komisioneve për likuidim. Sa unë jam i informuar, tanimë ajo është çështje e përfunduar, komisionet janë duke u punuar dhe unë shpresoj që edhe ajo pjesë e likuidimit të jetë sa më e shpejtë. Ndërsa në momentin kur kryhen këto dy ligje, ne do të mund t'i investonim këto mjete edhe në Kosovë, jo vetëm këto, por edhe para të tjera të Trustit të Pensioneve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputetja, Suzana Novoberdali, pyetje për ministrin Fatmir Limaj. Fatmiri nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen, deputete? Regjia, fjalën deputetes Suzan Novoberdali.

SUZAN NOVOBERDALIU: Faleminderit, kryetar!

Qëllimi i paraqitjes së pyetjeve është marrja e përgjigjes. Prandaj, me shpresë se ministri Limaj do të prezantojë në seancën e radhës, do ta bëj pyetjen atëherë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti, Riza Smaka, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputeti s'është. Deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin, zëvendëskryeministrin apo ministrin e Ekonomisë dhe të Financave. Deputet, e ke fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit! Çështja: Kohë më parë, saktësisht të hënën, më 26 tetor, pra para rreth dy muajve është lanësuar fushata ndërkombëtare mediale për përmirësimin e imazhit të Kosovës nga Kompania izraelite Saatchi & Saatchi me fokus gjeografik fillestar - Evropën dhe Amerikën. Kurse më vonë fokusi do të zhvendoset në vende të caktuara. Sipas deklaratave të udhëheqësve të Qeverisë, me theks të posaçëm të kryeministrit, nëpërmes kësaj fushate imazhi i shtetit të Kosovës fillimisht do të prezantohet në rrjetet më të shikuara televizive siç janë: CNN, BBC, WORLD, EURO NEWS, BLOOMBERG dhe EURO SPORT dhe më vonë edhe nëpër revistat me renome, SV ekonomist dhe NEWSWEEK. Që nga fillimi i kësaj fushate, pyetja është, pra, brenda këtyre dy muajve sa herë dhe kur konkretisht dhe në cilat rrjete televizive të lartpërmendura Kosova është reklamuar? Pyetja i bëhet ose ministrit të Ekonomisë dhe Financave ose e kemi edhe zëvendëskryeministrin. Faleminderit!

KRYETARI: Cili po e doni fjalën? Urdhëro, ministri Shala!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari deputet Tali, Unë e kam kënaqësinë që kam informacione të mjaftueshme për këtë dhe më lejoni në vijim t'ju raportoj juve dhe Kuvendit këtu për pyetjen e juaj, përndryshe ndoshta do të duhej të vrente që këtë çështje e përcjell grupi ndërmintoror prej 5 ministrave, në të cilën janë edhe ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Arsimit, ministri i Kulturës, ministri i Kthimit, Zyra e Kryeministrit, ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe, më duket, ministri i Tregtisë. Kështu, është formuar edhe një grup, një sekretariat, nëse mund të them, nga secila ministri, eksperti i saj. Ndërsa lidhur me pyetjen konkrete, më lejoni që të paraqes para jush, sa vijon:

Në CNN janë emituar 65 spote, prej 26 tetorit deri më 4 nëntor.

Në BBC EUROPE janë emituar 56 spote, nga 26 tetori deri më 22 nëntor.

Në EURO NEWS janë emituar 82 spote, nga 26 tetori deri më 15 nëntor,

Në CNN Turk janë emituar 60 spote, nga 26 tetori deri më 4 nëntor,

Në Bloomberg nga 30 spote, nga 27 tetori deri më 31 tetor,

Në EURO SPORT do të emitohen më 11 janar 5 spote.

Gjithashtu, janë emituar spote në Espanyol, sa e di unë, ESP 1 dhe ESP 2, - 5 spote, më 26 tetor.

Do të emitohen së shpejti përsëri në CNN EMA, 21 dhjetor deri më 28 dhjetor - 71 spote.

Në SKY NEWS EMA, 21 dhjetor deri më 28 dhjetor, - 62 spote.

Në CNBC, vetëm në Evropë, 4 janar deri më 11 janar, - 44 spote, ndërsa sa u përket gazetave THE ECONOMIST, THE NEWS WEEK kanë botuar nga një insert secila dhe planifikohet që në THE ECONOMIST të ketë edhe dy inserte të tjera, ndërsa në NEWS WEEK edhe një. Gjithashtu, do të ketë edhe dy inserte në THE PARLIAMENT, 2 në EUROPEAN VOICE - 2 dhe në POLITICO -2 spote.

Deri më tani janë vendosur në Prishtinë 50 bilborda, madhësia 4 x 3, ndërsa sa i përket gazetave vendore, janë planifikuar 80 publikime në të gjitha të përditshmet dhe disa janë

realizuar ndërkohë, mesatarisht 7 për secilën gazetë. Tre publikime janë në dy javoret: Prishtina Inside dhe një në HOME AND AWAY.

Vetëm në nëntor janë 100 emitime në RTV 21, 118 në RTK, 102 në KTV, TOP CHANNEL është qe nja tri javë në nëntor, KLAN KOSOVA, FAN TV dhe disa web faqe, siç janë Ekonomisti RKS.com, Ekonomia.com e tjera e tjera.

Të gjitha këto, nëse jeni të interesuar, unë do të lus sekretariatit i cili punon, që të ju dërgoj juve në mënyrë që t'i keni edhe të shkruara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, a ke pyetje shtesë? Fjala deputetit Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti ministër, a na tregoni se në çfarë kohe janë dhënë ato spote në atë numër shumë të madh, një. E dyta, arsyen pse e bëj këtë është, zoti ministër, se në CNN deri më tani në asnjë kohë, them, sociale nuk e keni publikuar punën e Kosovës, po ashtu as në BBC WORLD, as në BLOOMBERG, kohë sociale jam duke thënë, jo atëherë kur njerëzit nuk i shohin, domeni i qytetarëve të cilët ju doni t'i targetoni. Po ashtu, zoti kryeministër, zoti ministër në këtë rast, se kryeministrin nuk e kemi, nuk e di se sa është e mençme që Kosova, shtetin e Kosovës t'ia reklamoni kosovarëve nga fakti se ne kosovarët të parët e kemi pranuar shtetin e Kosovës, po edhe do të investonim në Kosovë sikurse të kishim para, po them, sikurse të mos na vidhnin, të na grabitnin të tjerët, do të investonim edhe paratë. Pra, kjo është një farë t'u qitet hi syve qytetarëve të Kosovës, por jam shumë kurioz të dijë se në çfarë kohe po i reklamoni ...

KRYETARI: Faleminderit! Ministri tha se ju njoftoj me shkrim. Urdhëro, ministër.

MINISTRI AHMET SHALA: Nëse m'i jepni nja 20 minuta, i kam fatmirësisht të gjitha këtu.

Zoti Kryetar, vetëm 2 – 3 copa do t'i përmendi, sigurisht.

Më 26 tetor, thotë, ONMANDEJ, në ora 20:00 CNN EMA,

Më 26 tetor, në orën 21, në ora 20, CNN EMA, për zotin nuk po shkruan këtu a me kohën e Amerikës a me kohën e Evropës. Qe, me BBC e paskam, me BBC, thotë, më 26, mandej 20:00 deri 24:00. Gjithashtu, në ESPANYOL prej 21:00 deri 21:15. Janë të gjitha këtu, unë do t'i jap të gjitha, nuk jam ekspert i medieve. Unë jam i sigurt që ekspertët që e kanë bërë, e kanë zgjedhur kohën më të përshtatshme si në aspektin e efekteve të marketingut edhe të temave të cilat janë bërë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja, Suzan Novobrdali, pyetje për ministrin Valton Beqiri.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Në ministrinë tuaj ka një numër mbi 200 të punësuar, pagesa e të cilëve bëhet nga kategoria e subvencioneve, do me thënë që paguhen jashtë sistemit të rregullt të pagave. Ky numër i të punësuarve është në institucionet kulturore, por ka edhe nëpër departamente.

Zoti ministër,

Cila është baza ligjore e pagesave të këtyre të punësuarve në ministri?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI VALTON BEQIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Novobrdali,

Para së gjithash, ju falënderoj që keni ngritur shqetësimin për këtë çështje, një çështje shumë të rëndësishme, një çështje e cila shqetëson po ashtu edhe Ministrinë e Kulturës. Dua t'ju korrigjoj se numri i përgjithshëm i tyre nuk është 200, por është diku rreth 330 të punësuar, pra numri i të punësuarve që nga paslufta, pra është një numër i trashëguar nga paslufta dhe ende nuk kemi një zgjidhje përkatëse dhe mundësi që ata t'i fusim në listë të rregullt të pagave.

Ministria e Kulturës, pra, vazhdimisht ka parashtruar kërkesa të rregullta për të zgjidhur këtë çështje dhe këto kërkesa janë bërë që nga data 11 shkurt të vitit 2008, 20 shkurt 2008, pra në kohën kur ka qenë ministri i Kulturës edhe zoti Skender Hyseni dhe në mbledhjen e Qeverisë të datës 27 shkurt 2008 është dhënë një sugjerim që të gjendet zgjidhje afatgjate. Po ashtu, meqë nuk kemi pasur zgjidhje, me datën 13 mars 2009 dhe gjatë shtatorit të vitit 2009 përsëri kemi kërkuar që të gjendet një zgjidhje afatgjate. Deri atëherë, pra deri më tani ne pagat e personelit të institucioneve kulturore i paguajmë në pajtim me Udhëzimin administrativ të thesarit dhe të MEF-it numër 2005/09, ku përcaktohet që të punësuarit me kontratë mbi vepër të paguhet me pagë bruto.

Po ashtu, kemi edhe një rekomandim nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave që për punëtorët shtesë të aplikohet kontrata për shërbime dhe atë në periudhë të caktuar kohore. Të gjithë e dimë se mandati i Ministrisë së Kulturës nuk është të gjejë zgjidhje, po të kërkojë zgjidhje dhe zgjidhjen afatgjate duhet të na japë ministria përkatëse, gjegjësisht Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

Por, më lejoni në fund t'ju them se deklaroj publikisht që pa marrë parasysh këtë situatë, gjatë mandatit tim, si ministër, besoj edhe gjatë mandatit të këtij Kabineti qeveritar dhe gjatë mandatit të juaj, pa marrë parasysh këtë fakt, ne nuk mund të lejojmë që institucionet më të rëndësishme kulturore shtetërore t'i mbyllim për këtë fakt. Besoj se në të ardhmen do të gjendet një zgjidhje më afatgjatë dhe më e mirë për të gjithë punëtorët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputetja Qamile Morina, pyetje për ministrin Alush Gashi.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Pandemia e gripit H1N1 është shpallur nga Organizata Botërore Shëndetësore në qershor të këtij viti, që atëherë qasja e Ministrisë së shëndetësisë në këtë drejtim ka qenë më tepër një paraqitje mediale triviale se sa një qasje serioze në krijimin e një plani të veprimi. Tani në mungesë të një plani pandemik gjithëpërfshirës, QKUK-ja po përballet me vështirësi të jashtëzakonshme në trajtimin e këtyre pacientëve, sidomos të atyre tejet të rëndë që po mbeten barrë e anesteziologëve për trajtimin e tyre. Duke theksuar se në Kosovë janë mbi 800 pacientë të dyshuar nga gripi H1N1, mbi 200 të verifikuar dhe 13 të vdekur gjer tani, andaj situata është serioze, sidomos kur parashihet vala e dytë në këtë fund vit.

Zoti ministër,

Përse edhe pas shpalljes së pandemisë së gripit në qershor nga OBSH-ja, nuk u organizuat të krijoni një plan pandemik që të menaxhohet sa më mirë kjo situatë?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Të nderuar zonja dhe zotëri deputetë dhe ministra,

Ju faleminderit, zonja deputete, për këtë pyetje kaq të rëndësishme që me të vërtetë është preokupim i ynë i vazhdueshëm. Me këtë rast falënderoj të gjithë punëtorët shëndetësorë të Republikës së Kosovës, si dhe qytetarët e saj në bashkëveprim për realizimin e rekomandimeve të OBSH-së.

Ministria e Shëndetësisë e ka planin veprues për parandalimin e gripit, plan i cili është hartua nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Që nga dita e parë e shpalljes së pandemisë, Ministria e Shëndetësisë ka pasur një qasje multisektoriale dhe karshi asaj pune ka arritur që edhe përkundër vështirësive reale që ekzistojnë në vendin tonë, ta ketë situatën në kontroll. Kosova ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, të cilat kanë të bëjnë me gripin. I kemi bërë të gjitha përgatitjet dhe trajnimet në të gjitha nivelet sipas rekomandimeve të OBSH-së. Është themeluar Njësia Intensive në Klinikën Infektive, kështu që janë rritur kapacitetet e hapësirës intensive në vendin tonë për 100%, por ne jemi të ndërgjegjshëm që kjo ende nuk mjafton. Kemi klinikistë të shkëlqyeshëm, por për çdo rast kemi kërkuar që Organizata Botërore e Shëndetësisë të na dërgojë një ekip të ekspertëve të trajtimit intensiv për të analizuar trajtimin klinik të pacientëve tanë.

Specialistët nga Organizata Botërore e Shëndetësisë kanë qenë, kanë vizituar Qendrën Klinike Universitare, spitalin e Pejës dhe të Gjakovës dhe përfundimi i tyre është që klinikistë të Republikës së Kosovës, në veçanti të Qendrës Klinike Universitare kanë bërë një punë të jashtëzakonshme dhe ata e kanë përdorë formulimin, - kemi qenë të fascinuar me ekspertizën e mjekëve kosovarë, të cilët edhe në mungesë të kapaciteteve të plota dhe në mungesë të pajisjes për këtë numër kaq të madh të pacientëve, janë duke bërë një punë të shkëlqyeshme. Nuk është sekret se vetëm Qendrës Klinike Universitare i mungojnë së paku edhe 30 anesteziologë. Për funksionalizim të plotë të kapaciteteve të intensive vetëm në Prishtinë na nevojiten së paku edhe 50 infermierë që do të punonin vetëm në intensive.

Buxheti është ky që është, prandaj ne jemi kah bëjmë përpjekje maksimale që edhe në bazë të Raportit të progresit, ku kërkohet freskimi i pajisjes dhe në veçanti për Qendrën Klinike Universitare të shikohet mundësia e marrjes së kredive afatgjate. Ne i lusim qytetarët e vendit tonë që në simptomat e para të gripit të paraqiten te mjeku, ku udhëzimet e OBSH-së janë që sa më herët të fillohet me terapinë e Tamiflusë, të cilën ne e kemi siguruar për gjithë qytetarët e vendit që konsiderohet që mund të jenë të përfshirë.

Numri i njerëzve të përfshirë me gripin AH1N1, ne jemi të bindur që janë me dhjetëra mijëra raste, por janë raste më të lehta. Vështirësia qëndron se në Qendrën Klinike Universitare të vendit tonë numri i shtretërve intensiv deri më tani ka qenë i vogël. Ne në infektive kemi dyfishuar këtë, jemi të përkushtuar që numrin e shtretërve intensiv me tërë pajisjen ta rritim në nivel që e ka rekomanduar Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Përveç kësaj, janë të funksionalizuara të gjitha intensivët e spitaleve rajonale. Nuk është sekret se qytetarët ia mësyjnë Qendrës Kline Universitare, si nivel terciar.

Andaj, duke ju falënderuar për pyetje edhe juve si anesteziologe, falënderoj të gjithë mjekët që me një përkushtim të jashtëzakonshëm janë duke e përballuar këtë situatë, e cila fare nuk është e lehtë. Siç keni dëgjuar nga ekspertë, është një sëmundje e re për të cilën jemi duke mësuar të gjithë. Mua më bën nder vlerësimi i OBSH-së për ekspertizën e klinikistëve të vendit tonë. Ne do t'i vazhdojmë përpjekjet për ...

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Edhe ashtu e ke pasur fjalën goxha gjatë. Deputete, ke pyetje shtesë?

QAMILE MORINA: Së pari, zoti ministër, do të shpreh mirënjohjen time për respektin. Gjëja më e vogël që mund ta bëni në këtë rast është që po e shprehni bile respektin për punonjësit shëndetësorë që po kalojnë nëpër situatë shumë të rëndë në trajtimin dhe menaxhimin e këtyre pacientëve, edhe duke ditur se i kanë pagat jashtëzakonisht denigruese.

Meqë keni plan pandemik, zoti ministër, ju lutem mos e mbani në sirtarë, po mundësoni të zbatohet, ngase kërkesa nga profesionistët e QKUK-së paska qenë që ta kemi një plan të tillë dhe nuk na është ofruar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Më duket ky ishte vetëm koment, ministër.

Vazhdojmë, deputetja Suzan Novobrdali, pyetje për ministrin Zenun Pajaziti. Ministri nuk është këtu, a doni ta lexoni pyetjen? Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Ahmet Shala, deputeti nuk është këtu. Dhe, pyetja e fundit, deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

NAIM RRUSTEMI: I nderuar ministër,

Posta dhe Telekom i Kosovës është futur në tregun e Telefonisë Mobile në Shqipëri. Operatori Vala përbën 30% të konzorciumit, që afroi 7.2 milionë euro për licencën e Telefonisë së katërt celularë në Shqipëri. Sipas të dhënave Post-Telekom i Kosovës ka bërë pagesën në vlerë prej 2.4 milionë euro, depozituar. Pyetja: - A mund të tregoni se në cilën fazë të zhvillimit të operimit në Shqipëri gjendeni?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Naim, të kisha propozuar takime mujore mbase me Bordin e PTK-së për t'i pasur të gjitha pyetjet, përndryshe me shumë kënaqësi po përgjigjem. Në bazë të informatave që unë sot i mora nga Bordi i drejtorëve të PTK-së dhe të ekzekutivit, gjendja tani në zbatimin e obligimeve që i ka Post-Telekom i Kosovës sa i përket licencës së katërt mobile në territorin e Shqipërisë, është se ata deri në janar e kanë ... përkatësisht ... që e kanë bërë dhe në të cilin janë paraqitur shumë kompani regjionale dhe vendore për zbatueshmërinë e programit. Procesi është në vlerësim e sipër, jam i informuar se e kanë kompletuar zyrën dhe gjithë stafin e kompanisë që është krijuar në Tiranë për zbatimin e këtij projekti dhe për informacione të tjera do informoheni në qoftë se keni pyetje tjera, përkatësisht sa i përket pyetjes që e bëtë, këto ishin përgjigjet që unë i kam marrë nga menaxhmenti dhe nga Bordi i PTK-së.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, ke pyetje shtesë?

NAIM RRUSTEMI: Të them sinjerisht, unë nuk kam dashur të bëj pyetje, por kur e pash në Kohë Ditore para tre dite që biznesmeni shumë i përfolur dhe kontrovers, Miroslav Mishkoviq, është në lidhje të biznesit të afërt me KEK-un, desha ta bëjë pyetje dhe pyetja ime shtesë është: A po i besoni që i keni paratë e sigurta me qenë se ky konzorcium është shumë i dyshimtë dhe shumë i përfolur, ka qenë i përfolur edhe në Shqipëri, është i përfolur se është drejtpërdrejt në lidhje me biznesmenin serb kontrovers, Miroslav Mishkoviq. A i besoni që i keni paratë e sigurta?

KRYETARI: Ministër, përgjigje shtesë?

MINISTRI AHMET SHALA: Zoti Naim, unë sinjerisht do të kisha lutur ta lexosh Ligjin për ndërmarrjet publike dhe korporata, i cili në mënyrë shumë precize e jep përgjegjësinë e Bordit të ndërmarrjeve publike dhe të ekzekutivit. Përgjegjës për marrjen e vendimeve afariste, definitivisht përgjegjës kryekëput komercial dhe ligjor është udhëheqësja e Post-Telekomunikacionit të Kosovës. Ne në bazë të informacioneve që kemi, të cilat i shqyrtojmë në grupin ndërmarrësor për ndërmarrjet publike, nuk duhet të besojmë ndryshe përveç në kompetencat profesionale që i ka Post-Telekomunikacioni dhe bordet e të gjitha ndërmarrjeve publike. Secili person, në qoftë se e shkel ligjin, ai është përgjegjës ndaj veprave të veta që i bën. Nuk ka përgjegjësi kolektive, përgjegjësitë janë të precizuara shumë mirë me ligj dhe me rregullat e korporatave. Andaj, kjo ishte përgjigja ime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Pyetjet e deputetëve që nuk morën përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në Buletinin e Kuvendit.

Vazhdojmë seancën. Pika e radhës:

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigorisë

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,

Projektligji për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigorisë, të cilin po e paraqes para jush, është paraparë me Strategjinë legjislativë për vitin 2009, Strategjinë legjislativë të Qeverisë së Kosovës. Qëllimi i këtij projektligji është themelimi i një sistemi unik për klasifikimin dhe rruajtjen e informatave që kanë të bëjnë me interesat e sigorisë së Kosovës, si dhe verifikimin e sigorisë së personave që kanë qasje në këto informata.

Ky projektligj do të zbatohet ndaj të gjitha institucioneve publike, përfshirë këtu: Qeverinë, ministritë, agjencitë ekzekutive të Qeverisë, si dhe institucionet tjera publike të degës ekzekutivitet. Pastaj, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe institucionet tjera publike të Kuvendit, Presidencën, komunat dhe institucionet tjera publike të komunave, organet e pavarura dhe sistemin e drejtësisë.

Ky projektligj do të zbatohet edhe ndaj shoqërive tregtare, organizatave joqeveritare dhe organizatave tjera të sektorit privat, të cilat pranojnë apo në cilindo formë tjetër kanë qasje në informata të klasifikuara nga autoritetet publike si rezultat i ndonjë marrëveshje në mes të institucioni publik dhe shoqërisë tregtare, organizatave joqeveritare apo çfarëdo organizate tjetër të sektorit privat.

Me këtë projektligj për herë të parë në Kosovë rregullohet në detaje klasifikimi i informatave dhe verifikimi i sigurisë në pajtim me kriteret e sigurisë të përcaktuara nga NATO, Bashkimi Evropian dhe standardet, konventat dhe detyrimet e zbatueshme ndërkombëtare.

Ky projektligj është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me institucionet tjera të Republikës së Kosovës dhe me miratimin e këtij Projektligji do të rregullohet në mënyrë ligjore klasifikimi i informatave dhe verifikimi i sigurisë dhe njëkohësisht do të zbatohet në mënyrë të përpiktë neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Radha është e shëfave të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë të respektuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës me vëmendje të përqendruar e ka shqyrtuar Ligjin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë dhe konsideron se është një ligj i hartuar mirë, i cili e rregullon një fushë për klasifikimin e informatave dhe e nisë kompletimin e infrastrukturës ligjore në fushën e sigurisë.

Ky ligj është i domosdoshëm për shoqërinë tonë dhe si të tillë Partia Demokratike e Kosovës e mbështet dhe njëkohësisht e përgëzon Qeverinë për profesionalizmin e treguar në hartimin e këtij ligji. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do të japë kontributin e vet edhe në shqyrtimin e vazhdueshëm në procedurën e dytë, do të thotë në shqyrtimin e komisioneve funksionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e mbështet, në parim, këtë ligj dhe do të japë gjithë kontributin e vet në trajtimin e tij në Kuvend deri në miratimin përfundimtar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës në parim e mbështet këtë projektligj dhe besojmë që në mes të dy leximeve do të japë kontributin e vet në përmirësimin e vërejtjeve që i ka.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AKR-së, deputetja Suzan Novobrdali e ka fjalën.

SUZAN NOVOMERDALI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah, në parim, këtë projektligj, kontributin do ta japë në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDD-së, deputetja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Lidhja Demokratike e Dardanisë, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji, në parim e mbështet dhe, natyrisht, do të japë kontributin e vet në komisionet funksionale. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, e ka fjalën.

MÜFERA ŞİNİK: Teşekkür ederim, Sayın başkan “7+” Parlamenter grubu bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabul etmektedir, ikinci okunuşuna dek yapılan çalışmalarda komisyonlarda katkısını sunacaktır. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të SLS-së, nuk ka.

Për diskutim është lajmëruar deputeti Naim Maloku, le të përgatitet deputeti Emrush Xhemajli.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministër, ministra,

Më lejoni që duke përgëzuar hartuesin e këtij ligji për një projektligj mirë të sistemuar që e sjell në Kuvend të Kosovës, për një projektligj, sipas mendimit tim, jashtëzakonisht të rëndësishëm që do të ndikojë në krijimin dhe ngritjen e infrastrukturës institucionale për t’u marrë me problematikën të cilën e përkufizon ky ligj, më lejoni që t’i jap vetëm disa vërejtje që unë i kam hasur gjatë leximit të këtij ligji.

Neni 5, që ka të bëjë me klasifikimin e ndaluar, paragrafi 1, pika 1.2, këtu thotë në paragrafin 1, neni 1, nuk lejohet klasifikimi i informatave për të..., 1.1 është fshehur shkeljet e ligjit, abuzimin e autoritetit, mosefikasitetin apo gabimin administrativ, që është kreu në rregull.

Paragrafi 1.2. thotë kështu, citoj: “Parandaluar turpërimin e një personi, autoriteti publik apo organizate”. Unë lus hartuesin e ligjit edhe komisionin funksional që do të shqyrtojë këtë ligj, që të përqendrojë vëmendjen në këtë paragraf. Disa veprime ose veti të

personave në shtetet perëndimore nuk janë turpërim në krahasim me, për shembull, në mesin ku jetojmë ne, dhe mos po ndikon ky paragraf, nëse miratohet kështu, që me këtë ligj ne t'i shkelim të drejtat elementare të njeriut që i kemi miratuar dhe i kemi garantuar edhe me Kushtetutë edhe me ligje të tjera. Unë besoj që deputetët e dinë për çka e kam fjalën dhe ku po e orientoj këtë vërejtje timen.

Në nenin 7, të nderuar deputetë, ka të bëjë me kapitullin - Kompetencat për klasifikim. Paragrafi 2, thotë kështu: Kompetencën origjinale për klasifikim në nivelin tepër sekret e kanë: dhe janë të numëruara pra sipas funksioneve personalitetet që e kanë këtë kompetencë, por në paragrafin 3, unë po e citoj: “Personat e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 7 kanë të drejtë që t’ia delegojnë kompetencën për klasifikim vartësve të tyre të drejtpërdrejtë”. Edhe këtu unë i tërheq vëmendjen komisionit funksional dhe hartuesit të ligjit që më duket se për klasifikim në nivelin tepër sekret, pra kur kemi të bëjmë me këtë shkallë të sigurisë, mendoj që nuk duhet lëshuar kompetencat në nivelin apo të vartësit e personave të cilët kanë kompetencë që t’i klasifikojnë këto informata në nivelin tepër sekret. Pra, niveli i klasifikimit që është tepër sekret, mendoj që nuk e lejon që kjo kompetencë të bartet edhe në varësitë e këtyre personaliteteve që janë të autorizuar me ligj, pavarësisht që këtu shkruan – t’i delegojnë kompetencën për klasifikim varësve të tyre të drejtpërdrejtë. Pra, këto ishin disa vërejtje të mia që i kam hasur duke e lexuar këtë projektligj. Ju faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Diskutuesi i fundit i lajmëruar është deputeti, Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I respektuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë dhe të pranishëm,

Projektligji për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë është një ligj me një rëndësi të jashtëzakonshme për stabilitetin dhe qëndrueshmërinë në vendin tonë. Deri më tash informatat as nuk ka pasur mundësi të klasifikohen, as të ruhen. Për mendimin tim, është një ligj i punuar mirë, nëse...

KRYETARI: Regjia, i bien ziles për deputetët që janë duke pirë kafe!

EMRUSH XHEMAJLI:...në projektligj janë cekur shumë mirë kriteret e klasifikimit, kriteret e klasifikimit të ndaluar, por kemi vërejtje te kompetenca për klasifikim. Konkretisht, neni 7, pika 2.9, te kompetencat e klasifikimit të informatave mendoj se duhet të dihet për cilat borde dhe agjencione duhet të ketë kompetencë për klasifikim, bëhet fjalë për tip tepër sekret të informatave. Agjencioni Antikorrupsion edhe ndonjë tjetër mund të ketë këtë të drejtë, por nuk është e nevojshme që agjencionet, bordet për menaxhimin e mbeturinave ose ART-ja, ose KPM-ja apo bordi i RTK-së ta ketë këtë të drejtë të klasifikimit për informata tepër sekretë. Mjafton, bie fjala, që disa borde të kenë klasifikimin vetëm kur është fjala te pjesa konfidenciale.

Neni 7, pika 9, koha brenda të cilës zyrtari duhet të klasifikojë informatën duhet, për mendimin tim, të rishikohet. Në projektligj thuhet se përgjegjësi brenda 30 ditësh duhet ta rregullojë informatën edhe ta klasifikojë. Është shumë e papërcaktuar, 30 ditë për disa informata është shumë e për disa të tjera është vonë. Sidoqoftë, këtu duhet të dihet se në cilat raste në momentin e dhënë me t’u prodhuar apo me t’u ditur informata duhet të klasifikohet. E paklasifikuar deri në 30 ditë x informata që ka qenë dashur të klasifikohet

qysh ditën, ndoshta orën e parë të prodhimit të saj, do të shpërndahej me apo pa qëllim, por që me këtë rast nuk do të përgjigjej askush për përhapjen e saj të paautorizuar. Tek e fundit, kjo pjesë duhet hartuar ndryshe dhe për faktin se neni 8 e përcakton këtë më saktë.

Në njërën anë thuhet se neni 12, pika 4, se autoriteti i klasifikimit që ka prodhuar informatën e klasifikuar, e bën një rishikim për çdo 5 vite, për të verifikuar nëse informatat e klasifikuara vazhdojnë të kërkojnë mbrojtje. Ndërsa, neni 11, thuhet se vendimi për informatat e klasifikuara që kërkojnë mbrojtje mbi 25 vjet, nuk guxon të merret më herët se 6 muaj para datës së paraparë për klasifikim sipas paragrafit 1.

Këtu, për mendimin tim, nuk ka koherencë të duhur sepse, ta marrim, nëse çdo 5-vjetëshi nuk përputhet me 6 muajt e skadimit të x informatës së klasifikuar që vazhdon të ketë nevojë për mbrojtje, sipas kriterëve ligjore del automatikisht pas 25 vjetësh, del pa dëshirën e autoritetit të klasifikimit. Është jashtëzakonisht mirë që po punohet ky projektligj dhe urojmë që sa më parë të aprovohet. Zbatimi i tij do të jetë një sprovë e vërtetë për persona përgjegjës brenda institucioneve të Kosovës për shkak të rrethanave që i dimë të gjithë.

Qasja në dokumentet zyrtare dhe klasifikimi i dokumenteve zyrtare që kanë të bëjnë me sigurinë e vendit, janë dy drejtime që duhet precizuar dhe dallimi të jetë i qartë ligjor. Për mendimin tim, në komisionin përkatës ka shumë punë lidhur me këtë edhe për faktin se, sipas memorandumit shpjegues, janë marrë disa përvoja të shteteve të caktuara, të cilat jo çdo herë janë të njëjta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! nëse nuk paraqitet ndonjë tjetër, i fundit është Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Unë mendoj që ky projektligj është mjaft në nivel, ka do të thotë arsye për ta përkrahur e për ta votuar në leximin e parë. Mirëpo, siç u tha, do të bëjmë çmos që në leximin e dytë të japim kontributin tonë, ndihmesën tonë që ky projektligj të jetë më i kompletuar.

Unë do të ndalem vetëm për dy çështje terminologjike, që ma merr mendja se duhet të herren për të ardhmen. Disa herë kemi dhënë vërejtje “nënkupton”, “nënkupton” po përdoret. Kjo fjalë “nënkupton” është edhe në fjalë, por në këto kontekste që po përdoret këtu edhe në këtë ligj, mund t’i shmangemi ndonjëherë, të mos e përdorin gjithnjë, po ta përdorim “është”, “paraqet” e tjera e tjera, sepse nëse gjithnjë, në të gjitha ligjet e marrim “nënkupton”, na lë përshtypjen se është nga përkthimi “podrazumeva” i serbishtes, po nuk është bash ai gjithkund, po diku po. Unë nuk po ndalem për t’u marrë kohën në cilat raste, por në leximin e dytë do t’i veçoj.

E dyta, parafjala “mbi” kudo përdoret, do me thënë “mbi dokumentet” e është aty teksti “për dokumentet”, që po e them kur jepet nocioni “dokumentet”, që e thotë edhe atë që e thashë më parë “nënkupton”. “Dokument nënkupton çdo mjet fizikë apo elektronikë mbi të cilën është regjistruar informata”, duhet “për të cilën është regjistruar informata”, e jo “mbi”, se është edhe kjo nën ndikimin e gjuhës sllave “o”, “danas ću govoriti o tome, i tako dalje”, e duhet “për”, “për” duhet.

Po ashtu, edhe kur është fjala “për” dhe “mbi”, diku përdoret “mbi qasjen”, për shembull, në faqen 29 shkruhet “mbi qasje mbi dokumentet” e duhet “për” si thashë, “për qasje” në faqen 31, do me thënë këtu është mirë, aty jo mirë. Lektori ose ai që e ka formuluar, e ka bërë këtë ligj, duhet t’i përmirësojë këto, t’i shqyrtojë dhe le të na dalin ligjet gjuhësisht pastër. Faleminderit, zotëri!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Nuk kemi të lajmëruar të tjerë për diskutim.

Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratim, në parim, të këtij projektligji. Prezentë janë 74 deputetë. Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional,
- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisioni për Buxhet dhe Financa,
- Komisioni për Komunitete, dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Këto komisione duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e radhës, pika e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat antidamping

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për masat antidamping dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Raportet me rekomandimet e Komisionit u janë shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, zonjën Myzejene Selmani, apo raportuesin e komisionit që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në bazë të punës së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion të datës 14.10.2008, miratoi në parim këtë projektligj, ndërsa më 21.07.2009 shqyrtoi dhe miratoi amendamentet e propozuara nga grupi punues i Projektligjit për masat antidamping dhe kundër balancues dhe paraqet për miratim në seancë plenare këtë raport.

Duhet t'ju them se gjatë përshkrimit të amendamenteve ka ndodhur një përshkrim gabim, amendamenti 44 starton mandej amendamenti 46, duhet të jetë amendamenti 45. kërkoj që Kuvendi të pranojë raportin, për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fillim dua të sqaroj që ne e kemi dhënë rekomandimin që të aprovohet, po për bazë juridike, sepse ju e dini që sipas rregullores ne në fillim e japim rekomandimin për bazë juridike, mirëpo unë do të ngreh disa probleme që janë bërë me rastin e amendamentimit dhe ndoshta do të ishte mirë që si deputetë të përqendrohemi pak në dokumentin që e kemi para vetes. Nëse e merrni dhe e shikoni amendamentin 3, amendamenti 3 flet për ndryshimin e qëllimit të ligjit. E keni nga sponzorizuesi, nga Qeveria qëllimin e ligjit, që është shumë i qartë dhe është në praktikën juridike dhe keni amendament ku është bërë qëllimi i ligjit, ku ju kanë vendosur 5 paragrafë, gjithsej ka diku 200 rreshta dhe nuk ka në praktika juridike qëllimi i ligjit me 200 rreshta. Do me thënë, nëse komisionet parlamentare duhet ndoshta të rregullojnë pak përmbajtjen, por jo të krijojnë situata që komplet e kemi në këtë rast, e kemi shkatërruar dhe i kemi krijuar 5 paragrafë për qëllimin e ligjit, që nuk është praktikë juridike.

Çështja tjetër, neni 2 flet për përkufizimet. Po e lexoj çka shkruhet. Neni 2, thotë, ndryshohet si vijon: Në praktikën që i kemi për amendamentet duhet të jetë propozimi nga Projektligji dhe propozimi i amendamentit. Nëse e shikoni, komplet është ndryshuar përkufizimi dhe ne, si deputetë, nuk do të kuptojmë tash a duhet ta votojmë ndonjërin propozim nga projektligji apo komplet propozimet nga komisioni parlamentar. Nëse duhet nga komisioni parlamentar, atëherë unë konsideroj që komplet janë ndërruar përkufizimet dhe ne nuk dalim në situatë që Zyra për standardizim, por as presidenti ta dekretojë ligjin, sepse e kemi ndryshuar komplet dhe jo në dobi, por në dëm të projektligjit.

Këto ishin vetëm për fillimin, kurse në çështjet konkrete, po ndalem te amendamentet. Shikoni amendamentin 6, thotë: “Neni 3 i Projektligjit, zëvendësohet me nenin e ri 3”. Nuk ka mundësi të zëvendësohet. Neni 3 ose duhet të propozohet nga komisioni, të fshihet neni 3 i projektligjit, i cili ka 3 paragrafë dhe të hartohet neni i ri, të zëvendësohet nuk ka mundësi. Nëse e shihni, këtu e kemi tash vetëm nenin 3, nuk e dimë se çka po ndodhë për paragrafët më tutje.

Amendamenti 7 shkruan kështu: “Shtohet një nen i ri, neni 4”. Në rregull, po shtohet një nen i ri, mirëpo amendamenti në vijim, amendamenti 8, thotë: “Neni 4 i Projektligjit zëvendësohet me nenin e ri 5”. Nuk ka mundësi dhe shtrohet çështja, nëse ne tash e votojmë nenin 4 plus amendamenti 8, që thotë neni 5 bëhet 4, një ligj po del me dy nene dhe nuk kemi mundësi mandej të vijmë në situatë. Mirëpo, ajo situata më shumë komplikohet kur thotë, neni 5, vlera normale. Këndeje shkruan neni 4, vlera normale. Neni 4 i ka 5 paragrafë, vlera normale tash e ka vetëm një paragraf. Situata edhe më tutje komplikohet, për shembull, neni 10. Neni 6, thotë: “çmimi i eksportit”, nëse e krahasoni me Projektligjin, është llogaritja e kostove në përcaktimin e vlerës reale, që i ka diku nja 7- 8 paragrafë rend, nuk po i përmendi të gjitha. Këtu është vetëm një, çka të bëjmë, cilin ta votojmë. Nëse e votojmë nenin 6, kemi votuar vetëm për një paragraf.

Mirëpo, edhe më tutje në projektligj mbetet neni 7, - Çmimi i eksportit. Është neni 6, propozim amendamenti, çmimi i eksportit mbetet në nenin e projektligjit - çmimi i eksportit. Çka të bëjmë? Prandaj, për të mos i lodhur deputetët, kërkoj që Zyra ligjore t'i ndihmojë stafit administrativ, në këtë rast kisha kërkuar t'i ndihmojë edhe komisionit, sepse duke dashur që të bëjmë diçka, kemi sjellë në situatë që komplet ia kemi humbur kuptimin projektligjit, që nuk ka qenë aq i dobët dhe kemi krijuar konfuzion. Kështu nuk do të duhej të votohej, por do të ishte mirë të tërhiqet raporti dhe në njërin nga mbledhjet e komisionit, në bashkëpunim edhe me Zyrën ligjore, por edhe të tjerët të ndihmojnë, sepse amendamentet nuk na vijnë në komision, përndryshe nuk do ta kishim lejuar të vinte kështu se komplet është diçka që e prishë strukturën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, ju faleminderit, po shumicën, mos të them të gjitha i tha kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Me të vërtetë ne e kemi miratuar këtë ligj, në parim, dhe tash ka ndryshime të mëdha, këto janë ndryshime esenciale. Nga 50 nene sa i ka pasur Ligji, tash na dalin 67 amendamente të propozuara, që nënkupton që komplet është një ligj i ri. Prandaj, e dimë edhe rregulloren, do me thënë...cili është hartimi i ligjit, mbi 50% do me thënë ose duhet t'i kthehet sponzoruesit, në këtë rast Qeverisë, ose duhet të rishikohet, sepse ka më shumë se 15 nene janë hequr tërësisht dhe kjo krijon konfuzion dhe me të vërtetë nuk do të dimë tash cila është esenca dhe përmbajtja substanciale e ligjit. Unë e ndaj mendimin me kryetarin e komisionit, sepse në këtë mënyrë edhe ne si deputetë, po edhe Zyra për Standardizim nuk do të ketë qasje efektive për miratimin e mëtutjeshëm të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ardian Gjini e ka kërkuar fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Për të mos e zgjatur, duhet pajtuar me shumicën e atyre që e thanë dy kolegët paraprak. Do të përsërisë diçka për hir të praktikave legjislative dhe parlamentare. Unë e kam thënë edhe në foltore të Kuvendit, nëse një ligj që sillet në Kuvend, ka nevojë për 67 amendamente. Ai ligj duhet kthyer. Nëse një ligj i ri me 50 nene vjen në Kuvend dhe ka nevojë për 67 intervenime, duhet kthyer. Këtë e kam thënë më herët. Na tregon disa elemente të ndryshme, do me thënë, ky rast dhe mendoj se duhet kthyer komplet ligji, të ripunohet se është praktikë shumë e keqe parlamentare. Neve na bien në situatë të mendojmë që edhe gjatë punës në komision, gjatë amendamentimit, nuk ka pasur njerëz të Qeverisë ose të Ministrisë përkatëse, të cilët kanë shkuar të punojnë me komisionin dhe kanë insistuar për t'i mbrojtur ose për t'i ndryshuar ato elemente, në mënyrë që mos të vijmë në këtë farë konfuzioni total, të mos e dimë as çka po aprovojmë.

Edhe diçka tjetër, e fundit është, do me thënë mua më pëlqeu ajo që e tha deputeti Bahri Hyseni, mirëpo ka qenë dashur pak më herët Komisioni për Legjislacion të japë rekomandime, të cilat i dëgjuam sot, për shkak se nëse e shihni te rekomandimet e komisioneve kryesore, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka vlerësuar se Projektligji për masat antidamping dhe kundër balancuese e ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Do të thotë, ky është paragrafi i vetëm që e kemi marrë prej Komisionit për Legjislacion. Do të thotë, këto që i dëgjuam sot, ka qenë dashur të mos na sillen fare në Kuvend. Propozim edhe i imi, besoj se ishte veç propozim implicit i dy kolegëve paraprak është që ligji të kthehet, të mos e procedojmë më tutje, të ripunohet dhe të vjen prapë në Kuvend i ripunuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Myzejene Selmani e ka kërkuar fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Duke marrë parasysh se ky projektligj gjatë amendamentimit në shqyrtimin e dytë ka kaluar nëpër të gjitha komisionet parlamentare dhe janë dhënë rekomandimet dhe njëkohësisht brenda Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri ka qëndruar një vit dhe ministri i linjës është i njoftuar se ne kemi dashur që ky ligj të kthehet në Qeveri edhe një herë për amendamentim apo të kthehet të punohet në mënyrën më të mirë, për këtë arsye ka pësuar këtë ndryshim kaq të madh nga stafi mbështetës, të cilët e mbështesin komisionin dhe ju e dini mjaftë mirë kush e mbështet Komisionin për Ekonomi, Tregti dhe Industri. Ju faleminderit!

KRYETARI: Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Unë mendoj që e sqarova në fillim. Sipas Rregullores në fuqi, ne japim bazën juridike, por e japim në fillim. Amendamentet nuk na i sjellin në komision. Do me thënë, duhet të shikojmë që në të ardhmen Komisioni për Legjislacion bazën juridike t'ua japë ligjeve, projektligjeve në fillim, do me thënë në lexim të parë, e jo në lexim të dytë, qysh po ndodhë, por duhet ta ndryshojmë me rregullore, sepse nuk kemi pasur mundësi, se nuk e kishim lëshuar. Nuk është çështja se pse ka ndryshuar ligji, nuk është do me thënë krejt çështja, por ka ndryshuar pa nevojë dhe në vend që të përmirësohet, komplet është bërë konfuzion. Në vend që qëllimi të ketë 5 rreshta, janë bërë 250 rreshta, që është tamam një ese, një roman dhe nuk ka qëllim të ligjit askund, merrni të gjitha ligjet. Ju e patë ligjin që e kaluam para 10 minutash. Prandaj, unë kisha kërkuar që të tërhiqet raporti dhe kërkohet vetëm edhe një herë që Zyra ligjore me komisionin ta shqyrtojë, amendamentet e panevojshme t'i eliminojë, t'i lë ato ku ka nevojë të intervenohet, natyrisht, për ndonjë çështje të caktuar dhe raporti mendoj që përgatitet vetëm me një seancë të komisionit dhe me një intervenim të Zyrës ligjore dhe të stafit mbështetës.

KRYETARI: A jeni dakord që të shtyhet dhe krahas amendamenteve të jetë dhe ligji dhe ta dimë se çka po ndryshohet, çka nuk po ndryshohet dhe le të jetë një ripërpunim i këtyre amendamenteve me ligjin bashkë, kështu që ta dimë çka po votojmë e çka nuk po votojmë, çka po mbetet dhe çka po hiqet. Unë mendoj kështu, qysh është, nuk e dimë çka po mbetet, as çka po hiqet. Do të thotë, e kemi propozimin që ky ligj të tërhiqet deri atëherë kur komisioni, në bashkëpunim me ministrinë ose përfaqësuesin e Qeverisë, na e bëjë një zgjedhje që është më e mirë dhe ne pastaj ta votojmë me rekomandimet e komisioneve. Urdhëro, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Në bazë të asaj që u punua deri tash, atëherë propozimi im kishte për të qenë që komplet ligji t'i kthehet Qeverisë, si ka qenë propozimi edhe brenda komisionit që të bëhet në mënyrën më të duhur dhe atëherë mos të amendamentohet 60% të ligjit, se edhe vet e keni thënë në mbledhje të Kryesisë së Kuvendit që nuk ka të drejtë të amendamentohet përmbi 40% të Ligjit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Et'hem Çeku e ka kërkuar fjalën.

ET'HEM ÇEKU: Ju faleminderit, Kryetar!

Këtu është edhe ministri prezent. Rreth këtij ligji ka pasur shumë debate, shumë diskutime edhe në leximin e parë ka pasur shumë amendamente, edhe në Komision ka pasur shumë debate se çka të bëjmë, a ta sjellim Ligjin në Parlament apo t'ia kthejmë sponzoruesit? Me gjithë ndërhyrjet e mëdha që janë bërë, unë mendoj që prapë nuk kemi arritur ta sjellim atë që po e thonë edhe kolegët. Unë propozoj po ashtu në emër të Komisionit, që është punuar shumë gjatë dhe ka mbetur mbi një vit duke diskutuar, bile ka pasur ide se për momentin Kosovës nuk i nevojitet ky ligj edhe shumë çështje të tjera, unë mendoj që t'ia kthejmë sponzoruesit, ta përgatisin dhe ta kthejnë prapë në Parlament. Në Komision nuk besoj se mund të ketë ndryshime esenciale, por në qoftë se e kthejmë me këto 60 e diçka amendamente, që janë bërë, të kthehet te sponzoruesi dhe për një kohë të shkurtër pastaj të sillet nga fillimi.

KRYETARI: Ministër, a ke ndonjë fjalë, a je dakord të kthehet ligji? Ne kemi mundësi të shkojmë edhe në lexim të tretë. A doni lexim të tretë? Urdhëro, Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Për procedurë, tash nuk kemi mundësi ta kthejmë ligjin te Qeveria, do me thënë Qeveria e ka sjellë një ligj, i cili konsideroj që nuk kanë nevojë këto amendamente që janë bërë. Shumica e amendamenteve që janë bërë dhe raporti e ka bërë konfuz, raporti që është krijuar e ka bërë konfuz, mendoj që mund të rregullohet në një mbledhje të komisionit me Zyrën ligjore, të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i Qeverisë, bile është edhe rregull të dëgjohet për ndonjë çështje dhe të sillet edhe një herë raporti me rekomandimet që dalin nga takimi i punës, sepse tash nuk është rregull, tash nuk kemi mundësi ta kthejmë në Qeveri, është punë që kryhet.

KRYETARI: Ju Faleminderit! Do të thotë, kërkesa është që ligji të shkojë në lexim të tretë. Lus deputetët dhe regjinë, le të përgatiten për votim dhe votojmë tash: Konstatohet se me 46 vota "për", 11 "kundër", 10 abstenime, Ligji shkon në lexim të tretë. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë së Privatizimit për periudhën gusht 2008 – gusht 2009

Agjencioni Kosovar i Privatizimit i ka parashtruar Kuvendit Raportin e punës për periudhën gusht 2008 – gusht 2009. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe ka rekomanduar miratimin e tij në seancë plenare.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare të Raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe ka rekomanduar miratimin e tij në seancë plenare.

Komisionet, a e donë fjalën? Fjalën e ka në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Në emër të komisionit, në marrëveshje me kryetarin e komisionit, dua kështu që vetëm të potencoj edhe një herë rekomandimin që e ka bërë ky komision lidhur me Raportin e punës së Agjencionit të Privatizimit. Por, shpresoj që këtë rekomandim e kanë edhe të gjithë deputetët.

Komisioni rekomandon që Kryesia e Kuvendit dhe ju, zoti kryetar, të kërkonin nga Qeveria që sa më parë ta procedojnë Ligjin për Odën e veçantë të Gjykatës Supreme, me qëllim që të shqyrtohen të gjitha ankesat dhe paditë e kreditorëve dhe të punëtorëve nga kjo odë, në kuptimin e asaj që të mundësohet puna në vazhdimësi e këtij institucioni. Edhe një sqarim që ka të bëjë me raportimin e komisionit të privatizimit, që ka të bëjë me muajin gusht. Kjo është shqyrtuar më 15 qershor 2009 dhe komisioni i ka rekomanduar Kuvendit që të miratojë raportin e agjencionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Myzejane, e doni fjalën? Mirë. Ju faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Safete Hadergjona.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!
Përshëndetje për ministrat prezentë,
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Raportin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe vlerëson të arriturat që janë bërë gjatë periudhës gusht 2008-gusht 2009.

Raporti sipas grupit tonë është gjithëpërfshirës, ka një material përmbajtësor, është i përgatitur sipas standardeve, ku njëkohësisht në këtë raport është i përfshirë edhe raporti financiar. Raporti paraqet, në përgjithësi paraqet gjendjen e trashëguar, punën e deritanishme, si dhe strategjinë për të ardhmen e këtij agjencioni. Është mirë që debati mbështetet në një dokument të shkruar, sepse procesi i privatizimit ka qenë një proces i mbyllur për qytetarët, njëkohësisht ka qenë proces i mbyllur edhe për Kuvendin.

Nga Agjencioni i mëhershëm Kosovar i Mirëbesimit nuk ka pasur asnjëherë raport nga ky Agjencion, kështu që çdo gjë që ka pasur të bëjë me privatizimin, ka qenë jotransparent. Aty ku nuk ka transparencë, jepet mundësia edhe që të dyshohet që ka pasur edhe keqpërdorime, mungesa e raporteve të tilla për një proces aq të rëndësishëm, është vlerësuar se ka qenë negative dhe tash po bëhet një diçka shumë më pozitive. Ky proces ka pasur rëndësi, sidomos për komunitetin e biznesit, sepse edhe përkundër ngecjeve të cilat kanë ekzistuar në këtë proces, vlera e eksporteve të ndërmarrjeve të privatizuara ka qenë pothuaj se dyfish, dyfishi i eksportit të pjesës tjetër të sektorit privat, çka do të thotë se procesi i privatizimit ka qenë një proces shumë i rëndësishëm i cili reflekton në ekonominë e tërë vendit. Me formimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit ka filluar hapja ndaj publikut të gjerë, ndërsa në hapjen ndaj Kuvendit, konsideroj që është bërë një punë e mirë.

Agjencioni Kosovar i Privatizimit që nga formimi në çdo tre muaj ka raportuar në Kuvend dhe Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Telekomunikacion si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa i kanë shqyrtuar raportet. Nëse analizojmë Raportin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, vijmë në përfundim se në këtë periudhë janë bërë punë të shumta, të cilat janë për t'u vlerësuar sepse vetë fakti i marrjes së kompetencave nga ky Bord pa asnjë dokumentacion aty, ka qenë një nga

problemet me të cilat është përballur dhe mund të vlerësohen të arriturat amë tutje. Ndonëse është filluar nga një gjendje jo e rëndomtë, janë bërë punë të shumta të cilat vlejnë për t'u theksuar, siç janë çështja e 20%-shit që duhet t'u takoj punëtorëve. Nga raporti shohim se 2752 punëtorëve u është shpërndarë kjo shumë në vlerë 3.5 milionë euro. Edhe përkundër mosefikasitetit të Dhomës së veçantë të Gjykatës së Lartë, ku sipas këtij raporti vërejmë se për analizat e saj, për secilën listë të publikuar, pra për analizat e saj në secilën listë të publikuar i duhen diku 3 deri në 6 muaj për rishikimin e ankesave.

Agjencioni Kosovar i Privatizimit ka bërë përpjekje për t'i rritur kapacitetet e veta njerëzore që kanë të bëjnë me rishqyrtimin e ankesave dhe ka formuar edhe Departamentin ligjor, të quajtur Paneli rishqyrtues i listës së punëtorëve. Megjithatë, në këtë drejtim mbetet shumë për t'u bërë, sidomos sa i përket 20%-shit dhe Fondit të privatizimit dhe çështjes së ndërmarrjeve të privatizuara me spinof special.

Nga raporti vërehet se Agjencioni Kosovar i Privatizimit është duke punuar për arritjen e qëllimeve të saj në procesin e privatizimit edhe përkundër problemeve të shumta me të cilat ende vazhdon të ballafaqohet, si me mungesën e dokumentacionit të pronësisë, do me thënë pamjaftueshmërisë së këtij dokumentacioni dhe të dhënave të vjetruara kadastrale. Në raport thuhet se Agjencioni Kosovar i Privatizimit planifikon që në tri vitet e ardhshme të përfundojë privatizimin dhe likuidimin e 599 ndërmarrjeve shoqërore. Raporti ngreh edhe çështjen e kthimit në Kosovë të Fondit të AKP-së, në lidhje me të cilin thuhet se normat e interesit kanë vazhduar të bien për rreth 10% në raportin e fundit të institucioneve financiare ndërkombëtare, ku mbahen këto fonde.

Agjencioni Kosovar i Privatizimit raporton se deri tani ka shpallur 7 valë të reja të privatizimit, deri më 12 gusht të vitit 2009, dhe ka grumbulluar 24.6 milionë euro nga shitja e ndërmarrjeve. Megjithatë, nuk ka qenë në gjendje që deri vonë të kryhet ndonjë likuidim për shkak të mungesës së Komisionit të Likuidimeve, i cili nuk është formuar në mungesë të zyrave rajonale dhe të personelit të nevojshëm. Ndryshe, nga marsi i vitit 2009, ka nënshkruar 54 kontrata të privatizimit me spinof të rregullt dhe 56 kontrata për likuidim. Në këtë raport është paraqitur edhe problemi me Brezovicën, me Trepçën dhe problemet e trashëguara me statusin e pazgjedhur të ndërmarrjeve të Gjakovës. Kjo Agjenci ka bërë të ditur se para privatizimit në Brezovicë ka vendosur të organizojë konferencë ndërkombëtare me investitorët, si dhe të bëjë një fushë marketingu për të njoftuar opinionin për vlerën e saj. Një pjesë të veçantë të këtij raporti i është kushtuar dhe problematikës të riorganizimit të Trepçës, ku Agjencioni Kosovar i Privatizimit i propozon Qeverisë që sa më shpejt të angazhohet për pajtim me kreditorët dhe rigjallërim të aktiviteteve të këtij kompleksi metalurgjik.

Agjencioni Kosovar i Privatizimit ka bërë të ditur se në aktivitetet e tij është i kufizuar për shkak të legjislacionit që rregullon problematikën e privatizimit në Kosovë, andaj kjo Agjenci ka kërkuar dhe përmirësimin e pjesëve të veçanta të Ligjit mbi Agjencionin Kosovar të Privatizimit, që kanë të bëjnë me spinofin special, si dhe me përzgjedhjen e drejtorit ekzekutiv. Vonesat në ndryshim-plotësimin e ligjeve ekzistuese që rregullojnë veprimtarinë e Agjencisë dhe të institucioneve tjera, si dhe mungesa e Ligjit për Odën e veçantë të Gjykatës Supreme, vërehet nga raporti se i kanë sjellë vështirësi Agjencionit Kosovar të Privatizimit për të kryer veprimtarinë e tij.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah Raportin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, si dhe përkrah edhe rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për përshpejtimin e procedurave për hartimin dhe dorëzimin në Kuvend sa më shpejt të Ligjit për Odën e veçantë të Gjykatës Supreme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes Raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën e përfunduar gusht 2008 – gusht 2009. Raporti, sipas vlerësimit tonë është përmbajtësor dhe plotëson edhe kushtet për miratim. Gjithashtu, ne e vlerësojmë punën dhe angazhimin e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe angazhimin e stafit në përmirësimin e gjendjes së krijuar pas marrjes së kompetencave. Edhe më tutje mbetet që të punohet shumë në procedurat e likuidimit. Çështja e 20%-shit të punëtorëve, njëherësh të shikohet edhe fondi i grumbulluar nga privatizimi, të kemi një plan dhe një propozim konkret, i cili dihet t'i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Infrastruktura ligjore dhe propozimet e dala nga rekomandimet e dala nga Komisioni për Buxhet dhe Financa mbështeten plotësisht, sidomos hartimi i Ligjit për Odën e veçantë të Gjykatës Supreme, i cili ka të bëjë me procedurat e shqyrtimit të ankesave dhe të padive të kreditorëve dhe të punëtorëve nga Oda e veçantë.

Grupi parlamentar i LDK-së, e thashë edhe një herë, e mbështet dhe i jep përkrahje në parim, ndërsa deputetët do të diskutojnë dhe do të japin angazhimin për çështjet të cilat i interesojnë edhe publikut. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e mori anëtar i Kryesisë, Ibrahim Gashi

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përshëndet fillimin e punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pas një pauze relativisht të gjatë gati dyvjeçare ndërmjet përfundimit të punës së AKM-së dhe fillimit të AKP-së. Kërkojmë që nga ky institucion, të përshpejtohet procesi i privatizimit dhe në veçanti të kemi një rritje të kujdesit në përgatitjen e privatizimit të ndërmarrjeve të cilat janë me rëndësi të veçantë për ekonominë e Kosovës, përgatitje, pra të veçantë dhe këto do të ishin disa prej tyre: Brezovica, Miniera e Boksitit e tjera dhe në veçanti të punohet në zgjidhjen e dilemës rreth së ardhmes së Trepçës. Siç po shihet nga raporti, në disa ndërmarrje të privatizuara me spinof special, ka shumë probleme për të cilat përgjegjësia tash bie edhe mbi Bordin e AKP-së, veçanërisht po e përmendi “LLamkosin, Fabrikën e Gypave, Hotel Grandin e tjera.

Një çështje tjetër për të cilën grupi ynë parlamentar angazhohet të kërkon efikasitet në veprim është grupi i ndërmarrjeve të komercializuara dhe grupi i ndërmarrjeve siç

është e njohur të ndërmarrjeve të Gjakovës, statusi i të cilave ende nuk është përfunduar edhe pse një kohë të gjatë, pra tash një vit AKP-ja, ka marr kompetencat e plota. Duhet të zgjidhet edhe dilema rreth pronësisë së Qendrës Kulturore- Sportive- Pallatit të Rinisë me komunën e Prishtinës. Me qenë se të gjitha kërkesat për buxhet të AKP-së, në Komisionin për Buxhet dhe në Kuvend janë përkrahur, janë përkrahur edhe nga Grupi Parlamentar i Aleancës, ne kërkojmë që të gjitha këto çështje që u përmendën në parim të dinamizohen dhe të bëhen më efektive, sepse nuk ka më asnjë pengesë objektive që e pengon Bordin e AKP-së, që t'i kryejë këto detyra dhe në veçanti po përmendim edhe një efikasitet më të madh në shpërndarjen e 20%-shit për punëtorët, edhe pse një pjesë, siç e kemi dëgjuar nga mjetet e informimit, bie edhe mbi Odën Speciale e përgjegjësi dhe duke i përmendur këto çështje si çështje që duhet të jenë në qendër të vëmendjes, me këto vërejtje Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet raportin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar atë AKP-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Behgjet Pacolli.

BEHGJET PACOLLI: E nderuara Kryesi,

Të nderuar kolegë,

Kam lexuar raportin e AKP-së dhe duhet t'ju them që Grupi Parlamentar i AKP-së nuk e përkrah, nuk e miraton atë punë që e ka bërë deri tani si Agjencia e Privatizimit që ka qenë nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut, po ashtu edhe këtë të AKP-së që është nën mbikëqyrjen totale të Qeverisë së Kosovës.

Privatizimi në Kosovë ka gjeneruar deri tani vetëm: mjerim, papunësi, varfëri në Kosovë dhe me përjashtim të shumë pak kompanive në Kosovë, duhet të them që privatizimi ka qenë tejet i pasuksesshëm dhe ne kemi arritur të tjetërsojmë pronën e prindërve tanë, të baballarëve tanë, të njerëzve që punuan me dinjitet, të tjetërsojmë atë pa identitet, pa një ardhmëri dhe pa asnjë plan-program. Paratë e grumbulluara nëpër Kosovë, janë inkasuar, janë dërguar në një adresë që populli i Kosovës, qytetari i Kosovës as nuk e din cila është ajo adresë dhe nuk din për fatin e tyre. Mund të kuptoj se ato para janë jashtë dhe ato sot rrisin ose gjenerojnë mirësi për shpekullantët e borzave të ndryshme, e fondeve të ndryshme financiare nëpër Evropë, kurse ata që nuk përfitojnë aspak prej saj është Kosova.

Privatizimi si i tillë, pra se të bëhet është dashur që të bëhet një studim. Agjencia e Privatizimit është dashur të jetë një agjencion i formuar prej njerëzve ekspertë, njerëzve ekonomistë të cilët është dashur të përpilojnë edhe një program, një studio të fizibilitetit e cila do të kishte pasur mundësi që të realizohet në Kosovë, por jo të parashihet se duhen të merren kaq punëtorë edhe duhen të bëhen kaq investime. Asnjë studim nuk ekziston, asnjë studim i denjë i cili parasheh, sidomos jam duke folur te sipërmarrjet me spinof, nuk parasheh një investim të denjë që do ta mundësonte atë objekt, gjegjësisht fabrikë që të funksionojë. Vetëm te marrim një shembull, nëse fabrika e "Llamkosit" ka pasur për detyrë që të blihet, të paguhet një shumë e tillë dhe të inkuadrohen, nuk e di sa qindra punëtorë dhe të investohet diçka, çka të investohet në atë fabrikë, çka riparohet në atë fabrikë? A flasim tash për programet që janë atraktive për situatën e sotme të ekonomisë së Kosovës apo për një program i cili është përpiluar ndoshta në kohën e ish-Jugosllavisë. Unë e them këtë fuqishëm se flitet për programe që janë përpiluar në kohën e ish-Jugosllavisë dhe çdo tentativë që të rijetësohet një program i tillë ekonomik, është i dështuar dhe këtë sot e ka demonstruar praktika në Kosovë.

Mendimi i AKR-së, por edhe i ekspertëve evropian me të cilin ne kemi kontaktuar dhe kemi studiuar një situatë më të mirë për privatizimin në Kosovë, thotë se privatizimi në këtë mënyrë duhet të ndalet automatikisht që AKP-ja duhet të formojë në familjen e vet një grup të ekspertëve, të ekonomistëve dhe njerëzve të denjë që dinë të përpilojnë programe, e atëherë këtu të flitet me blerësit potencial. Blerësi potencial nuk mund të jetë njeri i rastit, por duhet të jetë profesionist i denjë, me shpirt duhet të jetë që të jetësojë jetën ekonomike të objektit të cilin ata donë ta privatizojnë. Kjo punë nuk është bërë. Janë inkasuar paratë, paratë janë dërguar diku, si thash që as vetë nuk e dimë ku janë dhe ato nuk janë sot në dispozicion të ekonomisë së Kosovës. Prandaj, duhet të fillohet kjo punë më, të ndalet privatizimi. Sa më shpejtë të merren ekspertë nga vendi dhe jashtë dhe të bëjnë platformën e një ligji të denjë për privatizim. Kjo mund të bëhet për një muaj, një muaj e gjysmë, të paguhet njerëzit, por të kemi platformë të denjë të privatizimit. Mos të flasim për privatizimin që ka ndodhur në Gjermani para 25 vjetëve, atëherë kur ka qenë vëllai i madh dhe ka paguar për dëmet që privatizimi ka shkaktuar. Por, këtu duhet të flasim për ekonomi të vogla dhe të flitet për një program që ka shans për jetësim në ekonominë e Kosovës. Çka është shansi? Që objekti të prodhojë, të gjenerojë vende të punës, të gjenerojë njerëz të pasur, por jo njerëz të varfër, por jo papunësi dhe varfëri. Të përpilohet platforma ligjore për privatizim, të kalojë nëpër Parlamentin e Kosovës, të fillohet të implementohet prej AKP-së, të bisedohet me blerësit potencial, të bashkëbisedohet me ta dhe të gjendet ai që është më i favorshmi. Nëse është fjala për shitje të një objekti 1 milion dollarë dhe ai njeri ka 1 milion dollarë, nëse ato i ka paguar dhe nuk ka mundësi as shans për të jetësuar ekonomizimin e asaj fabrike, atëherë ne kemi gjeneruar edhe një njeri tjetër të varfër, por atij ndoshta t'i shitet fabrika me kredi, t'i japim shansin fabrikës që të punojë, që pronari i ri të gjenerojë para dhe prej fitimit që ai do të gjenerojë, ai do ta paguajë fabrikën, do ta paguajë fabrikën ndoshta edhe me dinjitet, me paratë që janë fituar dhe është një sotisfacion edhe për te. Mos të bëhet hap më tutje për privatizimin e ndërmarrjeve publike pa ligj, por së shpejti duhet që kjo Qeveri të shpallë konkursin, të sjellë ekspertë, të bëhet platforma ligjore për privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe ndërmarrjet publike nuk mund të jenë nën ndikimi e kësaj Qeverie, por kjo Qeveri duhet ta ndihmojë procesin, të formohet një agjencion i cili nuk është i Qeverisë, por një agjencion që do t'i përket gjeneratave të ardhshme. Ky agjencion duhet të ketë ekspertë e vet dhe këta ekspertë duhet të punojnë me blerësit potencial. Këta ekspertë duhet të vendosin kujt t'i shitët dhe çfarë forme t'i shitet kompania publike, a duhet të jepet me koncesion apo duhet ndoshta në një formë tjetër të shitet krejtësisht ose pjesërisht ose të jepet në formën BIO TI, do të thotë të ndërtohet, e shfrytëzon derisa t'i kthesh investimet tua dhe në mënyrë funksionale t'ia kthesh prapë pronarit legjitim? Këtu do të përfitojë ai agjencion. Gjeneratat e reja do t'i ndiejnë atë se nuk është tjetërsuar kompania që është ndërtuar prej prindërve tyre, një kompani që është e Kosovës, nuk është tjetërsuar për interesa private të dikujt, se do të përfitojë prej privatizimit, por ka përfituar, kanë përfituar gjeneratat e reja. Prandaj kësaj mënyre të privatizimit, ne e kemi ngritur zërin edhe përpara, duhet t'i jepet fund, duhet të bëhet platforma ligjore, duhet të kalojë nëpër këtë Parlament dhe duhet të implementohet prej njerëzve profesionistë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit parlamentar të LDD-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Ministër,

Deputetë të nderuar,

Është e qartë se rrjedhoja e procesit të privatizimit në Kosovë ka shkaktuar dëme të mëdha të pariparueshme deri tani, si tillë nuk ka shënuar kurrfarë impakti pozitiv për qytetarët, por në të kundërtën ka pasur impakt negativ, gjeneroi: varfëri, papunësi, papunësi, korrupsion, rënie ekonomike dhe sigurisht konsekuencat do t'i ndiejnë edhe fëmijët tanë. Andaj LDD-ja, raportin e punës njëvjeçare të AKP-së e konsideron me rëndësi të veçantë, ngase bëhet për herë të parë në Kuvend dhe e konsideron si raport të qartë, dhe konkret. Pjesa e parë e raportit pasqyron në çfarë gjendje të rëndë është pranuar ky agjencion nga AKM-ja. Pas flakës që iu vu këtu institucioni, është djegur dokumentacioni dhe ai konfidencial që ngriti shumë dyshime dhe duke pasur parasysh që dokumentacioni i privatizimit të tokës bujqësore ishte djegur.

Fatkeqësisht raporti i punës njëvjeçare të AKP-së, vetëm sa i ka potencuar vështirësitë, pengesat dhe sfidat...

KRYESUESI: Lus deputetët që të kthehen në sallë, sepse nuk kemi kuorum për të vazhduar. Lus deputetët që t'i thërrasë me zile.

QAMILE MORINA:... që po e përcjellin këtë proces që nga fillimi si dhe pengesat që i kalojnë kompetencat e këtij agjencioni dhe janë çështje e institucioneve të larta shtetërore dhe ndërkombëtare. Edhe pse Agjencioni Kosovar i Privatizimit, u themelua sipas Kushtetutës, si pasardhës i AKM-së, problemi kyç i AKP-së...

KRYESUESI: Ju njoftoj se, nëse nuk kthehen deputetët, pas këtij diskutimi duhet ta ndërpresim.

QAMILE MORINA:...ju lutem, në qoftë se mundeni, vazhdimisht jeni tri herë duke më ndërprerë, derisa, por një herë thajeni, ju lutem... edhe pse Agjencioni Kosovar i Privatizimit u themelua sipas Kushtetutës si pasardhës i AKM-së, problemi kyç i AKP-së po mbetet mosnjohja e këtij subjektiviteti nga Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila vazhdon të njehë AKM-në dhe kjo po krijon shumë vështirësi në kryerjen e procedurave gjyqësore të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me AKP-n dhe procesin e privatizimit.

Në kuadër të kësaj, shpërndarjen e 20%-shit për punëtorët, raporti i AKP-së, vë në pah se edhe përkundër vështirësive të mëdha në kompletimin e dokumentacionit dhe angazhimit të një numri të juristëve, janë në pritje të vendimit të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës. Procedurat e OVQ-së, për marrjen e vendimeve po e zvarrisin shpërndarjen e 20%-shit për punëtorët tonë, ngase kjo Odë njeh AKM-n dhe jo AKP-n. Krejt këto janë proces i dështimit që aq sa të AKM-së, aq janë përgjegjëse edhe institucionet tona shtetërore. Prolongimi i shpërndarjes së 20%-shit për punëtorët tonë është e pafalshme. Një çështje me rëndësi që po përballlet AKP-ja, ka të bëjë me asetet e ndërmarrjeve shoqërore që gjenden jashtë territorit të Kosovës. Agjencia e Privatizimit të Serbisë, është duke kryer shitjen e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës që gjenden në Serbi. AKP-ja ka kërkuar të ndërpritet shitja e tyre si dhe ka njoftuar Zyrën Ligjore të Presidentit, të Kryeministrit, Kuvendit, EULEKS-in dhe Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar. Askush nuk e din se a është arritur të ndalet ky proces nga institucionet tona shtetërore apo ndërkombëtare.

Gjithashtu, kthimi i pronës së Kosovës, në Mal të Zi po has në shumë pengesa, ngase autoritet gjyqësore të Malit të Zi refuzojnë ta njohin AKP-n. Sa është ndihmesa e institucioneve tona relevante për komunikim ndërshtetëror në sferën diplomatike me qëllim të gjetjes së një zgjedhjeje të përshtatshme nuk është e qartë, por gjithsesi është shumë e nevojshme. Situata me “Trepçën” bëhet e pazgjedhur dhe tejet e komplikuar. Vendimi për moratorium ende po vazhdon. Për “Trepçën” duhet të rregullohet statusi juridik, sepse vazhdimisht ka marrë subvencione dhe po vazhdon të marrë nga buxheti i Kosovës dhe atë nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, që ndan 5000 pensione për punëtorët e “Trepçës”.

Nuk ka dyshim e kjo statuskvo fare nuk është zgjidhje afatgjate dhe kjo do të kërkojë kujdes të veçantë të institucioneve tona shtetërore për një betejë juridike se kush do ta administrojë “Trepçën” në të ardhmen? Sa i përket pjesës veriore të “Trepçës”, AKP-ja nuk ka informata apo qasje direkte. Metoda e sipinofit special nuk ka treguar rezultate dhe është përdorur për ndërmarrjet që konsideroheshin me rëndësi strategjike në Kosovë dhe asnjë prej tyre nuk ka treguar rezultate edhe pse si storie e suksesshme tentohet të prezantohet “Feronikeli” dhe sa e sa herë në këtë Kuvend kemi dëgjuar diskutimet e argumentuara se “Feronikeli” ka gjeneruar humbje dhe assesi fitim kolektiv. Shembuj tjerë, janë “Llamkosi” apo Fabrika e Duhanit në Gjiilan apo Fabrika e Radiatorëve “Jugotermi” në Gjiilan, që kanë falimentuar.

AKP-ja, në janar të vitit 2009 ka kërkuar nga Baka Qendrore që të gjitha fondet e mirëbesimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të kthehen menjëherë në Kosovë si arsye e luhatjeve financiare dhe humbjeve në tregjet financiare botërore. Përgjigja e Bankës Qendrore ka qenë se të gjitha fondet e AKP-së, të depozituara në Bankën Qendrore janë të sigurta. Edhe pse Qeveria pat premtuar kthimin, gjegjësisht ngjalljen apo nxjerrjen e të gjitha atyre mjeteve që janë jashtë qarkullimit të hyjnë në qarkullim, qoftë këto të privatizimit apo ato që janë mbledhur në procese të tjera të grumbulluara e që mbahen në vend apo jashtë vendit, nuk arriti të mbajë premtimin. Për një ekonomi të zhvilluar kaq mjete jashtë qarkullimit janë dëm i madh e lere me për ekonominë e Kosovës. Mirëpo, deputetë të nderuar, Kosova, sot më shumë se kurrë po thërret për veprime e jo për pretime.

Ajo që me të vërtetë më ka befasuar shumë është norma e interesit të këtij fondi mbi 400 milionë euro dhe është vetëm 0.10%, kjo me të vërtetë nuk do koment. Andaj në fund, Lidhja Demokratike e Dardanisë përkrah raportin e AKP-së dhe konsideron se procesi i privatizimit i të mirave ekonomike të popullit të Kosovës ka qenë jo transparent, jo konkurrues dhe ka pasur raste që është bërë kundër interesave kombëtare, gjë që ka lënë dyshime të mëdha te qytetarët e Kosovës. Përmbyllja e procesit të mbetur të privatizimit, me siguri do të kërkojë transparencë, qartësi, mbi të gjitha vetëdijesim, pjekuri morale dhe shtet formuese të institucioneve tona shtetërore që e tëra të kthehet në të mirë të qytetarëve tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka kërkuar deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsedavajući!

Ja mislim da je pitanje koje je ovog momenta na dnevnom redu, da mu se nije dovoljno ozbiljno i odgovorno prišlo, jer nismo dobili niti dovoljan broj informacija, niti neke detaljnije izveštaje i ja se pridružujem onim kolegama koji ovo pitanje smatraju mnogo

značajnijim, jer možda je naš interes za ovo pitanje nešto manji jer se vidi tu i po prisustvu predstavnika ministarstava i po prisustvu poslanika i po tome što je stavljano sada, faktički sasvim pri kraju našeg rada u ovoj godini, ali mislim da je to pitanje od velikog interesa za građane koji su ostali nezaposleni, čije su firme prodane ili treba da se prodaju, i mislim da sa pristupom koji imamo o ovom pitanju, ne mogu građani biti zadovoljni. Ja se slažem sa kolegama koji su pomenuli da treba što pre usvojiti zakon, da što pre treba pravnu proceduru regulisati kako bi firme koje se prodaju imale vrlo jasan pravni status, odnosno novi kupci koji budu, pre svega prema onima koji su do tada bili zaposleni a potom i da preuzmu teret određene proizvodnje o čemu je gospodin Pacoli govorio, a one nikako da firme koje se privatizuju kasnije postanu rentakar, odnosno da se izdaju samo pod kirijom. Mislim da ovom pitanju treba mnogo ozbiljnije da pridjemo i da..., mi kažemo Parlamentarna gupa „7+“ u načelu prihvatamo ovaj izveštaj, prihvatamo takodje i formiranje posebne komore, ali je sigurno da treba na dnevni red jednom sasvim drugačije da pristupimo procesu privatizacije, znajući iskustva nekih zemalja koje vrlo jasno stavljaju fondove na raspolaganju pre svega onima koji su te firme gradili. Kažem, mi prihvatamo ovaj izveštaj, ali smo zato da se ovom problemu pristupa mnogo ozbiljnije, odgovornije uz prisustvo predstavnika Kabineta, uz mnogo više podataka kako bi smo mogli malo i legitimnije i spremnije da govorimo. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk kemi të paraqitur për diskutim. Kalojmë në diskutimet e deputetëve sipas radhës. Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri, le të përgatitet deputetja, Myzejene Selmani.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Çështja e privatizimit në Kosovë ka qenë një çështje kontraverze që nga fillimi i punës së saj për shumë arsye, mirëpo, unë do të thosha se disa nga çështjet që kanë qenë më pasoja dhe më kontradiktore janë të lidhura me Fondin e privatizimit, i cili në vend se të përdorej për investime në Kosovë, ka mbetur i ngrirë dhe unë mendoj se kjo çështje do të duhej të adresohet edhe sa më shpejtë ky fond të vihet në shërbim të interesave të vendit.

E dyta, është me rëndësi që në këtë periudhë të privatizimit janë disa ndërmarrje me rëndësi strategjike për vendin dhe për çështjen e privatizimit të tyre, duhet pasur shumë kujdes për arsye se pasuritë natyrore të një vendi janë përcaktues të rëndësisë gjeopolitike të atij vendi, qoftë në raport me rajonin, por edhe më gjerë. Mendoj se këtu u përmendën disa nga këto kompani, pra, siç është vetë “Trepça”, por edhe të gjitha kompanitë tjera që kanë të bëjnë me pasuritë strategjike të vendit tonë. Sigurisht se në këtë kuadër nuk mendoj se do të duhej të bllokohej procesi i privatizimit, por duhet të shqyrtohen mundësitë e korporatizimeve apo edhe koncesioneve, në vend se e tërë kjo pasuri të kalojë në sektorin privat.

Çështja tjetër që dua të diskutoj, ka të bëjë me intervenimin që këto ditë UNMIK-u ia bëri Agjencionit për Privatizim, që nuk la shijen e mirë, sepse Kosova tashmë është shtet i pavarur dhe kjo agjenci është shumë me rëndësi që është tashmë pronësi e qeverisjes vendore dhe është shumë me rëndësi që në këtë proces ne jemi vendimmarrësit e kësaj çështjeje. Disa probleme tjera që vazhdojnë që nga koha e punës së AKM-së, kanë të bëjnë me atë se punëtorët kanë mbetur pa pagesë, përmes privatizimit nuk është zgjidhur çështja e papunësisë që ishte një prej faktorëve që stimuloi këtë proces dhe me këtë rast, më

lejoni të përmend një rast të rëndë i cili ka të bëjmë me njësitin e ndërmarrjes “Dardania” në Prizren, Hoteli Prizren, pra, i cili është privatizuar në vitin 2007, mirëpo punëtorët ende nuk e kanë marrë 20%-shin e tyre si dhe huat që kjo ndërmarrje i ka marrë për ekzistencën deri në momentin e privatizimit, ende nuk janë kthyer nga ana e Agjencionit për Privatizim. Këso probleme ka të shumta, unë e mora një shembull, në mënyrë që, në kuadër të përfundimit të raportit, të merren parasysh dhe këto rekomandime dhe të dalin si detyra të reja për të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputet! Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani, le të përgatitet deputetja Kaqusha Jashari.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet për dy ministrat apo vetëm për ministrin e Shëndetësisë që është sot këtu dhe të gjithë deputetët që janë brenda kësaj seance,

Shqyrtimi i Raportit të AKP-së, nga Grupi Parlamentar i AKR-së është bërë në mënyrën më të caktë, duke parë se AKM-ja, vazhdimësi e AKP-së, ka dështuar plotësisht në privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore.

Raporti i AKP-së, kryesisht përmban përshkrimin e gjendjes si është marrë nga AKM-ja, dhe si mendohet të vazhdohet më tutje me procesin e privatizimit, mirëpo metodologjinë e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, me një sukses më të madh për zhvillimin ekonomik të Kosovës nuk e ka paraqitur brenda këtij raporti. Në raportin e punës së AKP-së jepet pasqyra e organizimit të AKP-së dhe rrjedhja e privatizimit, në raport heshtjet lidhur me privatizimin e tokës bujqësore, shkaktojnë një konfuzion, sepse sipas raportit, dokumentacioni është djegur nga AKM-ja. Për këtë arsye këtu ka shumë paqartësi dhe AKP-ja lidhur me këtë duhet të sqarohet deri në fund, jo vetëm të thotë se është djegur dokumentacioni dhe tash nuk kam informacione.

Çështja që ka të bëjë me 20%-shin dhe problemet që po i has AKP-ja janë pagesat që u takojnë punëtorëve rreth 20%, procesi i likuidimit që po zgjat tepër dhe procesi i privatizimit. Në ligj shprehimisht thuhet se procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore duhet të kryhet sa më shpejtë. Mirëpo, roli i kësaj agjencie është t'i transformojë ndërmarrjet shoqërore nëpërmjet një procesi transparent dhe konkurrues, me ligj kërkohet që prona shoqërore të kalojë në pronë private. Një angazhim i madh i AKP-së, duhet të jetë edhe shpërndarja e 20%-shit, këtu po zgjatet procesi, sa që shumë punëtorë edhe janë kah vdesin dhe nuk mund ta marrin 20%-shin. Për listat finale, thuhet se aktualisht jemi në pritje të vendimit të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme dhe posa të merret vendimi nga Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme, menjëherë do t'i kryejmë transaksionet për punëtorët të cilëve u ka takuar 20%-shi. Mirëpo, në anën tjetër Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme arsyetohet se ka shumë ankesa dhe nuk është normal që për dy- tri ankesa të mbetet e paguar, të mbetet e pakryer pagesa për një listë të tërë të punëtorëve. Në anën tjetër, me një problem që po ballafaqohet Agjencia ka të bëjë edhe me ndërmarrje që janë privatizuar me spinof special. Disa nga këto ndërmarrje nuk i kanë plotësuar kushtet as atëherë të privatizohen me spinof special, duke marrë parasysh se ato shumë mirë po shihen se kanë dështuar. Kemi rastin e “LLamkosit”, ku zotëriu me firmën e tij në Bullgari është vetëm i dështuar dhe rasti i “LLamkosit” dështon edhe këtu dhe të gjithë punëtorët tash mbesin, ku mbesin. Lidhur me ndërmarrjet e Gjakovës, për fat të keq ende nuk është definuar statusi i tyre, që është kërkesë ligjore. Kjo tregon se ka shumë neglizhencë dhe duhet të ecë më shpejtë në këtë proces. Sa i

përket rastit të “Trepçës,” AKP-ja shprehimisht nuk ka arsye të qartë në bazë të raportit se çfarë rruge duhet ndjekur dhe ky është një propozim serioz, pasi dihet se “Trepça” ka marrë vazhdimisht subvencione dhe po vazhdon të marrë nga buxheti i Kosovës.

Sa i përket pjesës veriore të “Trepçës”, de fakto nuk jepen informacione dhe janë shumë të pakta. Si ligjvënës, unë kisha për detyrë t’ju them se duhet të bëhet ndryshimi i ligjit të AKP-së për arsye se Ligji i AKP-së, është miratuar me pakon e presidentit Ahtisari dhe gjatë përkthimit janë lëshuar shumë gabime, ku për këtë arsye AKP-ja mund të ketë edhe probleme gjatë implementimit të ligjit, për arsye se nuk është përkthyer në metodën e duhur kur është përkthyer ligji. Gjithashtu, siç përmenda edhe më lart, një nga problemet thelbësore është mos përmbushja e kontratave sipas spinofit special.

Privatizimet dhe investimet direkte të huaja duhet të jenë shumë fitimprurëse për një vend me ekonomi të zhvilluar, klasë punëtore të organizuar mirë dhe institucione të fuqishme shtetërore, gjë që po shihet këto nuk janë, të cilat kanë zbatuar një legjislacion të kompletuar të sferës ekonomike, mirëpo konkurrenca dhe legjislacioni prapë mungojnë. Mirëpo Kosova është larg të qenit një vend i tillë, ekonomia jonë është e pazhvilluar, hapja e tregut ndaj mallrave dhe investimeve nga jashtë është automatikisht përjashtuese ndaj ndërmarrësve vendor. Thjesht, pa ndihmën e shtetit, nuk mund të shtyhem me korporatat e mëdha me fuqi ekonomike shumë më të mëdha se krejt Kosova. E njëjta gjë vlen edhe për ndërmarrjet publike me njësitë e veta. Shteti, gjegjësisht Qeveria duhet të përcaktojë kursin, platformën ligjore dhe jo vetëm pasuese e rekomandimeve që merren nga vetë stafi i kësaj Qeverie.

Në vazhdim, pos tjerash dua që përfaqësuesit e AKP-së, MEF-it dhe të Qeverisë të japin sqarime cilat janë objektivat e AKP-ës për privatizim të suksesshëm kur dihet se deri më tani janë të dështuar. Çka do të ndodhë me ndërmarrjet e privatizuara me spinof special të cilat kanë dështuar, siç është rasti i “Llamkosit”? Çka po ndodh me kompleksit turistik Brezovica, çka po ndodh me kthimin e mjeteve të grumbulluara kur dihet se ende shteti i ri i Kosovës nuk ka ligj për Fondin nga privatizimi, ngase Bordi ka marrë një vendim që ato të kthehen në Kosovë dhe t’u jepen bankave komerciale, mirëpo, çka po ndodhë me të?

Një tjetër problem që është ajo më brengos gjatë raportit tuaj, ku thuhet se ende në një mënyrë po funksionon AKM-ja, kur dihet se pas 17 Shkurtit shteti i ri i Kosovës funksionon në bazë të ligjeve të pakos së Presidentit Ahtisari. Kjo çështje duhet të trajtohet në një nivel më të lartë në ato qendrore. Po ashtu përmenden dy vendime të vonshme të ish- AKM-së, cilat janë ato vendime të ndjeshme për Kosovën të cilat i ka marrë ish- AKM-ja kur dihet se me Ligjin për AKP-n, i cili ka ardhur me pakon e Presidentit Ahtisari funksionale për shtetin shtetin e ri të Kosovës është Agjencioni Kosovar i Privatizimit? Dhe, fakti i raportuar se menaxhmenti i ndërmarrjeve në Serbi ka filluar t’i privatizojë pronat e ndërmarrjeve të Kosovës paraqet një problem të veçantë me të cilën AKM-ja duhet të merret. Thuhet se janë informuar: Presidenti, Kryeministri, Kuvendi, Zyra Civile e EULEX-it, por nuk sqarohet çka është ndërmarrë deri më tani te këto institucione, a ka përgjigje rreth çështjes dhe a ka hapa konkretë të ndërpritet kjo?

Kisha t’i rekomandoj Kuvendit të Republikës së Kosovës që në Raportin e Agjencisë Kosovare 2008-2009, pas sqarimeve në heshtje duhet t’i jepen edhe sqarimet tjera të cilat u ngritën më lartë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari, le të përgatitet deputeti Heset Cakolli.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit!
Ju përshëndes të gjithë juve që jeni prezent.

Raporti i Agjencionit Kosovar të Privatizimit mendoj se është një prej raporteve më të kompletuara që kemi shqyrtuar në Kuvend, në krahasim me raportet tjera, agjencionet tjera dhe ky raport ka vetëm një pjesë të shqyrtimit çka ka bërë Agjencioni prej datës ose ditës të aprovimit të ligjit, prej qershorit 2008 deri sot, domethënë, për një vjet e jo edhe këtë çka ka qenë diskutim që edhe unë po pajtohem me diskutuesit para meje edhe metodat e privatizimit. Unë mendoj se për çështjen e metodave deri më tani të privatizimit ka vend të diskutohet, ani që ka mbetur shumë pak të privatizohet. Për periudhën prej 2002 deri 2008 AKM-ja ka privatizuar objektet më të rëndësishme.

Momentalisht AKP-ja i privatizon tokat dhe unë po frikohem që s'do të kemi shumë shpejt vend as për të ndërtuar shkolla as ambullanta, prandaj sa për metodat e privatizimit duhet të shqyrtohen. Unë sa për informim po ju tregoj se 14 pika të mospajtimit, Partia Socialdemokrate, më 2002 ia ka dorëzuar AKM-së, po kurrkush as nuk i ka shqyrtuar as nuk ka pasur, faktikisht metodat janë të imponuara.

Unë po e lë këtë temën për të cilën kisha folur shumë se privatizimi deri më tani nuk ka qenë në funksion të zhvillimit ekonomik, as të zvogëlimit të papunësisë, por sa mund më tutje të ndërmerren masat për ta ndalur këtë mënyrën e privatizimit ajo është çështje tjetër?

Po kthehem në temën e raportit. Agjencioni në raport po shkruan dhe është e vërtetë, ky Kuvend e ka aprovuar ligjin, është pasardhësja e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit. Unë kisha thënë që është ajo vetëm de jure a në fakt nuk është, sepse kanë filluar prej zeros. Është përmendur problemi i djegies së dokumentacionit, është në raport, ka edhe probleme të cilat i ka pasur AKP-ja në kompletimin dhe po shkruan se është kompletuar dokumentacioni, po për mua ky problem nuk është më tutje i AKP-së, në qoftë se ka dokumentacion, po është i hetimeve të organeve përkatëse që këtë problem që ka qenë dhe që ka ndodhur, ka qenë krim, nuk mund të lihet anash edhe të mbyllet, prandaj hetimet duhet të vazhdojnë.

Çështja për të cilën kisha thënë disa fjalë është për Odën e Veçantë, e cila ka qenë e përmendur edhe prej tjerëve, por unë mendoj se këtu ka vend të intervenimit edhe nga Kuvendi. Oda e Veçantë është vazhdimësi e punës dhe pjesës- AKM-së. Oda e Veçantë, po shkruan edhe në raport, e pranon UNMIK-un. Me formimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit ka vazhduar punën ani që ky, AKM-ja është shpërbërë, nuk funksionon me aprovimin e ligjit, por Oda, po. AKP-ja ka pasur problem me punën, me angazhimin ndaj Odës së Veçantë dhe ka formuar Komisionin për Ankesa, edhe këto probleme nuk janë ndalur. Domethënë, ankesat shumë ngadalë po shkojnë, prandaj ka edhe efekte negative në ndarjen e 20% punëtorëve, për të cilin janë bërë shumë fjalë dhe unë nuk do të vazhdoj, vetëm kisha thënë që punëtorët të vazhdojnë të ankohen, sikur që sindikata e Hotelit Grand që i ka çuar letër edhe Kryetarit të Kuvendit tonë, i ka çuar letër edhe Presidentit të Kosovës, edhe Kryeministrit dhe kurrkush me këtë problem nuk merret, jo me problemin e vet "Grandit", por në tërësi Odës së Veçantë. Në qoftë se ne duhet

Ligjin për formimin e AKP-së ta plotësojmë dhe ta shënojmë qartë rolin e Odës së Veçantë, unë mendoj se atëherë është obligimi ynë, i Kuvendit.

E treta, këtu më është krijuar edhe një dilemë se në komisione kur kemi shqyrtuar këtë raport, përfaqësuesi i Agjencionit për Privatizim ka thënë që këto 430 milionë të grumbulluara janë në menaxhim të Autoritetit Bankar dhe kanë kërkuar me shkrim çka ka ndodhur me këto mjete? Sot në pyetjen e deputetes, zotëri Ahmet Shala ka deklaruar që këto mjete janë të bllokuara dhe janë këtu. Po më duket që këtu nuk ka paqartësi, por ka një fshehtësi. Ku janë këto mjete, a janë te ne të bllokuara apo banka menaxhon jashtë? Prandaj ky Kuvend ka të drejtë ta di çka po ndodhë? Tjetër është problemi i përdorimit dhe i futjes në funksion të zhvillimit ekonomik, po ku janë mjetet, ta dimë ku janë? Kemi të drejtë për ta kërkuar si Kuvend.

E katërta, në lidhje me privatizimin me metodën spinof special. Është deklarimi i AKP-së që më me këtë metodë nuk do të privatizohet asnjë objekt, asnjë ndërmarrje, por çka me ato ndërmarrje që këtu në raport ka shumë të përshkruara mirë për çdo objekt, për çdo firmë që nuk i kanë plotësuar kushtet e kontratës? Unë kam dijeni një vendim të Bordit që e kanë aprovuar për këto ndërmarrje dhe për kriteret të cilat do të aplikohen dhe masat të cilat do të aplikohen në qoftë se kompanitë nuk i kanë plotësuar kushtet prej kontratës, sidomos kushtin i cili është më serioz dhe që se kanë aplikuar, investimet e reja të deklaruara dhe në kontratë të shënuara. Prandaj, lehtë ka qenë dhe po them ani që është problem i madh me “Llamkosin” se është tërhequr vetë firma, e cila e ka blerë “Llamkosin” dhe janë krijuar probleme tjera, por çka me ato objekte ku nuk është bërë investimi, ka filluar, janë rrënuar objektet, por ato kriteret të cilat i ka aprovuar Bordi i AKP-së, s’e di sa mund të zbatohen, të merren, të kthehen dhe të bëhet privatizimi tjetër. Kush e mbron vendimin e AKP-së, kush është mbrapa vendimit të AKP-së? E kemi problemin e zbatimit të ligjeve tjera, funksionimi i shtetit në shumë sfera nuk shkon si duhet, a do të mbrojnë gjyqi apo kush, prandaj edhe AKP-ja do të ketë shumë problem t’i zbatojë vendimet e saj për ato objekte të cilat janë privatizuar me metodën spinof special a nuk janë plotësuar kushtet. Përndryshe ky raport, si raport mendoj se është i mirë dhe do ta përkrah, por nuk e lidh këtë raport me metodën e privatizimit e cila është temë tjetër dhe unë mendoj se për këtë temë që kanë qenë edhe në diskutimin para meje duhet të merret seriozisht, se e kemi lënë këtë të punojë dikush sipas qejfit të vet dhe të shkatërrohet edhe ajo që e kemi pasur, të blihen objekte me shumë tokë, për shkak të tokës dhe ndërtimit të objekteve banesore e jo për zhvillimin ekonomik dhe për punësimin më të madh që ka qenë një prej detyrave të para të privatizimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Heset Cakolli le të përgatitet deputetja Vezira Emrush.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari, ministër Gashi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për Agjencionin Kosovar të Privatizimit ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2008 dhe AKP-ja është e obliguar sipas ligjit t’i raportojë Kuvendit të Kosovës për punën e bërë për periudhën njëvjeçare.

Ky raport, të cilin e kemi para vetes, mbulon periudhën kohore gusht-2008 deri në gusht të vitit 2009 dhe mund të konstatojmë se raporti është i përgatitur teknikisht mjaft mirë dhe jep një pasqyrë të qartë të punës së AKP-së për periudhën kohore të cekur më lartë.

Por unë mendoj në të ardhmen është mirë që të përgatitet një raport i përgjithshëm për procesin e privatizimit, prej valës së parë që ka filluar në maj të vitit 2003 e deri në momentin kur përgatitet raporti i ardhshëm i punës së AKP-së. Prej vitit 2003 e deri në fillim të vitit 2008 janë shitur gjithsej 498 ndërmarrje në shumë prej 392 milionë e 280 mijë e 728 euro. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore ka qenë kërkesë e kohës, por ky proces gjatë kësaj periudhe kohore është përcjell me vështirësi të shumta, si në aspektin politik, ashtu edhe atë ekonomik e tjera dhe nuk e ka arritur qëllimin kryesor të tij i cili ka qenë zhvillimi ekonomik i vendit, por fatkeqësisht e ka rritur numrin e të papunëve dhe nuk pritet që në një periudhë të afërt kohore të zhvillojë një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik në vendin tonë.

Një numër i madh i ndërmarrjeve shoqërore janë privatizuar me spinof special, ku disa prej tyre afarojnë pozitivisht, por ka edhe të atilla që nuk janë në rrugë të mirë për përmbushjen e obligimeve sipas kontratës për shitblerje, por ka edhe ndërmarrje të cilat i kanë përmbush të gjitha obligimet e parapara me kontratë por tani ato ndërmarrje nuk punojnë fare, do të thotë se e kanë ndërpre aktivitetin biznesor në tërësi. Shtrohet pyetja, a ka ndonjë strategji Agjencioni Kosovar i Privatizimit se si të veprohet me këto ndërmarrje? Por është edhe një numër i caktuar i kompanive të privatizuar me spinof special dhe janë në rrugë të mirë për përmbushjen e obligimeve të marra me kontratë. Unë me këtë rast po përmend Fabrikën e Tubave në Ferizaj, Mulliri i Silosit në Zërxë, Fabrika Fon sh.p.k - Podujevë e shumë ndërmarrje të tjera.

Të nderuar deputetë, unë mendoj se Agjencioni Kosovar i privatizimit duhet t'i mbështesë në të gjitha format e mundshme ato kompani që e kanë përmbushur marrëveshjen e zotimeve mbi 50% dhe janë në rrugë të mbarë për afarizëm pozitiv, për arsye se kompanitë e privatizuara, pas privatizimit kanë kaluar nëpër një periudhë ku kushtet e afarizmit kanë qenë shumë të pafavorshme, sidomos kur kemi parasysh krizën globale financiare botërore dhe kushtet e marrjes së kredive në bankat komerciale vendore, si dhe shumë vështirësi të tjera.

Unë me këtë rast dua të potencoj edhe një çështje që është dhënë në Raportin e progresit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, fjala është për privatizimin e tokave bujqësore. Të dhënat e paraqitura në Raportin e punës së Agjencionit Kosovar të Privatizimit tregojnë se dikur AKM-ja dhe tani AKP-ja kanë shitur gjithsej 25 mijë e 945 hektarë tokë bujqësore me çmim mesatar 3 mijë e 121 euro. Çmimi i tokave bujqësore ka qenë shumë i ulët, ka pasur raste kur një hektar është shitur vetëm për 1 mijë e 163 euro apo thënë vetëm 11 euro për ari. Unë mendoj se më mirë do të ishte sikur të ishte ndarë toka bujqësore në parcela më të vogla, ndoshta 25, 50 po edhe 100 hektarë, ku do të kishin marrë pjesë më shumë palë të interesuara dhe çmimi i shitjes sigurisht do të ishte me qenë më i lartë dhe ndoshta në këto raste kishin për ta blerë tokën bujqësore ata persona të cilët merren dhe mendojnë të merren me bujqësi edhe në të ardhmen.

Me ligjet e aplikueshme është rregulluar se tokave bujqësore nuk mund t'u ndryshohet destinimi pas privatizimit, por shtrohet pyetja sa sipërfaqeve të tokave bujqësore i është ndërruar destinimi dhe tokat e shituara tani a janë duke u shfrytëzuar apo eksploatuar nga pronarët e rinj apo kanë mbet pjesa dërrmuese e tyre djerrina?

Në fund kërkoj nga AKP-ja që të përshpejtojë me ndarjen e mjeteve për 20% të punëtorëve dhe të shikohet mundësia e dhënies së kredive me shkallë të ulët të interesit nga mjetet e 80% të privatizimit atyre kompanive që janë në rrugë të mirë për aktivizimin

e kapaciteteve prodhuese apo shërbyese dhe që i kanë përmbushur obligimet sipas kontratës mbi 50% të privatizuar me spinof special, për shkak se privatizimi i ekonomisë së Kosovës është bërë në një periudhë krize globale financiare dhe shumë e shumë vështirësive tjera që kanë përcjell afarizmin e atyre kompanive që janë privatizuar. Ju faleminderit, zoti kryesues.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush, le të përgatitet deputetja Mimoza Ahmetaj.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč! Pozdravljam sve prisutne. Jako sam razmišljala da li da se javim ali mislim da imamo danas jako važan izveštaj Kosovske agencije za privatizaciju i milo mi je da po prvi put pozdravimo jedan ovakav izveštaj. Medjutim, kada se malo preciznije pročita izveštaj, kažem sa moje strane, ja nisam zadovoljna sa izveštajem, jednostavno zato što se izveštaj bavi jako sa svojom agencijom, sa opisom, popisom a ne bavi sa stvarnim stvarima koje se u regiji i u samoj agenciji dešavaju.

Jednostavno od pretpostavljenog gospodina Dino Asanaja imamo nekoliko pisma kada se obraća UNMIK-u, EULEX-u i ne znam kome kada je nasledio od Agencije, od Kosovske Agencije, Poverilačke kosovske agencije dokukmenta, što svi znamo u kakvom je stanju to nasledio ali to nije razlog bio zato što je ova agencija osnovana na inicijativu Skupštine i Vlade, te ova agencija i da nije imala podatke, mi svi znamo u elektronskoj ili u fizičkoj formi da podaci mogu da se naprave zato što su ugovori na terenu, mogu da se uzmu od svih poverenika koji su privatizovali preduzeća i da se napravi arhiva, što mislim da nije bauk, jedno.

Drugo, to sam htela da kažem da se Agencija bavi jednostavno sa nekim pitanjem koje može da se reši sa radom od nepunih mesec dana.

Drugo pitanje koje je jako važno, moram da kažem da je ovo jako osetljivo pitanje, da je pitanje privatizacija pitanje svih pitanja. Zašto kažem pitanja svih pitanja? Zato što je u privatizaciji najviše prisutna korupcija. Mi danas jednostavno stavljamo pod tepih korupciju, za koju smo prozvani od strane Evropske Unije i ja sam se nadala da će ovaj mladi gospodin koga sam imala priliku da upoznam, da će više da se bavi sa metodom kako je sve privatizovano i da li možemo biti zadovoljni, ako je ovo preko 590 preduzeća identifikovano kao društvena preduzeća na Kosovu, ako su od toga prodata 490 za samo 400 miliona, znači ja imam običaj da kažem – me zbripte, na sniženoj ceni za milion dinara jedno preduzeće i tih 400 miliona danas dobijamo odgovor od ministra na ime pitanja gospodje poslanice Pantina da jednostavno ne zna se gde su sredstva fonda. Mi znamo ovde svi, mi smo poslanici, nismo nepismeni ljudi, da je to Fond za privatizaciju, Fond od privatizacije. Taj fond, svi fondovi su neprifitabilni, ne mogu se davati u inostranstvo za sticanje kamate ili bilo čega. Fondovi se daju samo na čuvanje bankama. Mi moramo ovde da dobijamo odgovor koja banka, na kom nivou u inostranstvu ili ovde kod nas čuva ova sredstva, zato što su sredstva Fonda neprifitabilna.

Drugo, da se jednostavno ispoštuju, rekli smo, čuli smo po kojim metodama je vršena privatizacija, što je jako žalosno da je to bila metoda ubrzana spinof i ubrzana spinof metoda, što možemo lepo da kažemo da je ova metoda samo stvarala socijalne probleme. 60 hiljada zapošljenih radnika je našlo sebe na ulicu, bez nedobijenih 20% i jednostavno 45 hiljada radnika čeka na sudske odluke. A zamislite Kosovo danas nije potpisnik

Medjunarodnog suda u Strazburgu, a sve ove tužbe radnika načiće se jedan dan i pred Strazburgom, a mi se o ovome u opšte ne brinemo, jednostavno se ponašamo i meni je žao što je ovaj gospodin mladi, direktor nije dao do znanja koje sve opasnosti prethode svim gradjanima koji nisu nama kao Skupštini, kao institucijama od strane gradjana koji nisu zadovoljni sa načinom na koji je privatizacija vršena.

Drugo pitanje je, ja sam imala prilike u zadnje vreme da se naš premijer javno hvali kako će da privatizuje i javna preduzeća. Medjutim, sa kojom metodom, da li je napravio ekonomski i socijalni program. Javna preduzeća imaju 11, samo elektroprivreda ima 11 hiljada radnika, pošta, kako će još 20 hiljada radnika da ode na ulicu, sa kojim programom, kako da privatizuje? Mora da ima program sa kojim, mi znamo sa kojim se problemima danas bavimo ovde, koje smo probleme zapravo stvorili na Kosovu. Mi znamo da je konačno rešenje statusa preduzeća i utvrdjivanje strategije razvoja samog preduzeća na nama i utvrdjivanje uplaćivanja nepovezanog staža i neplaćanje doprinosa za socijalno i zdravstveno osiguranje radnicima, da li će nam i preduzeća privatizovati samo tako što nam hvali 10 godina staža, da li će radnici pristati na to. Radnici će imati prava da nas tuže pred medjunarodnim organima, jer mi danas smo država i država u regiji... To što sam čula od kolega ovde, ne znam tačno od koga, ili od samog izveštaja da privatizacija na Kosovu nije isto kao privatizacija u regiji. Molim vas, svaka radnja, da li je to privatizacija, da li je ovo, sve se vrši na ime zakona, medjunarodnih zakona, mi uskladjujemo našu politiku države sa medjunarodnim zakonima. Ako nas jednostavno ne interesuje kako se u regiji privatizuje, po čemu su ti zakoni postavljeni, onda ćemo imati velike posledice, ne samo socijalnih nemira, nego i utuživanja. I jedno pitanje koje hoću da pokrenem ovde, videla sam da je Šar proizvod ovde opisan za privatizaciju i neću da čitam, da ponavljam da je koliko hektara ovo zemljišta ima i sve, ali jako me interesuje kakvu strategiju ima Vlada i sama Agencija za privatizaciju, da li se pobrinula, vidim da više brine UNDP za te prostore i za razvoj poljoprivrede i za smanjivanje siromaštva i svega, da li to treba da bude naša briga ili to treba da bude briga neke strane institucije. Za sada toliko. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete! Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj dhe pastaj do të shkojmë në pauzë të drekës.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Raporti i Agjencionit Kosovar të Privatizimit është raporti i parë që i është dërguar këtij institucioni të lartë të Kosovës për debat dhe është hera e parë që një raport të tillë e diskutojmë në Kuvend dhe nuk diskutohet në Nju-Jork apo në Bruksel, ashtu siç është bërë deri tani. Do ta përgëzoja Bordin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit për përgatitjen dhe stafin për përgatitjen e një raporti të tillë kaq mirë dhe aq korrekt, si për nga ana formale, ashtu edhe për nga përmbajtja.

Nga ajo që e kam parë në raport, çështjet të cilat janë mjaft shqetësuese do t'i përmendja tri të cilat përmenden në fillim të raportit dhe është çështja e ligjit për Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme dhe mendoj se si organ ligjvënës që jemi duhet të shohim si ta adaptojmë Ligjin e Odës së Veçantë, i cili si i tillë ashtu si është krijon probleme shtesë për punën e punëtorëve, listave të punëtorëve në Agjencionin Kosovar të Privatizimit. Gjithashtu çështje tjetër me rëndësi e cila është përmendur në raport është mosnjohja e Agjencionit Kosovar të Privatizimit nga e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme dhe përfshirja e UNMIK-ut në rastet në gjykata atëherë kur ka të bëjë me punëtorët.

E treta, është po ashtu edhe dokumentacioni i pamjaftueshëm i të dhënave apo të dhënat e vjetruara kadastrale. Siç është përmendur në raport Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme ka shumë ngarkesa me padi dhe ankesa prej kreditorëve dhe punëtorëve.

Ajo çka unë mendoj se do të duhej të bëhej përveç rekomandimeve të Komisionit, i cili i ka dhënë, është edhe ajo që e përmenda në fillim, domethënë, të bëhen ndryshime në ligje dhe të adaptohen në rrethanat e reja që Kosova, tashmë është dhe t'i adaptohen, domethënë, Agjencionit Kosovar të privatizimit dhe Kosova të mos funksionojë me ligjet të cilat ka funksionuar Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit.

Të kërkohet po ashtu nga UNMIK-u të kthehen të gjitha dokumentet e Bordit të drejtorëve të AKM-së në posedim të Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Të sqarohet çështja e Odës së Veçantë e Gjykatës Supreme e cila kritikohet për mosfunksionimi të këtij organi për shkak të mungesës së gjyqtarëve lokalë në raportin e progresit të Komisionit Evropian në faqen 11, përmendet, po e citoj se “Dhoma Speciale e Gjykatës Supreme përgjegjëse për rastet që lidhen me privatizim është e paralizuar për shkak të mungesës së gjyqtarëve lokalë”. Kjo është një çështje me shqetësim të veçantë.” Është fundi i citatit. Do të kërkoja nga Bordi dhe nga stafi të sqarohet një gjë e tillë, është për shkak të mungesës apo është- ku çalon dhe ku qëndron çështja? Të shikohet mundësia e privatizimit, mundësia sa më e mirë e privatizimit të ndërmarrjeve të Gjakovës që edhe kohë më parë u përmend sot në këtë debat, si dhe kompleksi turistik i Brezovicës, siç është mjaft ndjeshme, si dhe brengë tjetër janë ndërmarrjet e ndryshme që Kosova i ka jashtë Kosovës dhe të cilat dhe sidomos në Serbi të cilat kanë filluar të privatizohen, domethënë këto janë çështje që mendoj se krijojnë, kanë ngritur shqetësim dhe janë të interesit të veçantë për Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në orën 14:30 vazhdojmë seancën.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

Të nderuar deputetë,

Nëse askush nuk e lëshon këtë seancë, kemi 41 të pranishëm dhe mund të vazhdojmë me diskutimet, ndërkaq për votim presim të tjerët që të na bashkohen. Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Naser Rugova.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e kam lexuar me vëmendje këtë raport të Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe pothuaj se është identike me atë të 28 majit që e patëm diskutuar në atë seancën tonë ku edhe më tutje AKP-ja dëshiron të distancohet nga AKM-ja. Harrohet se çdo institucion përbëhet nga njerëzit, aq më shumë kur kemi të bëjmë me institucionet e natyrës së ngjashëm. Pra, anashkalohet fakti se të gjithë të punësuarit, pothuaj se të AKP-së janë ish të punësuarit e AKM-së, si Bordi, ta marrim për shembull, kemi rastin e kryetarit që ishte nënkryetar i AKM-së, pastaj edhe 2 anëtarëve të Sindikatës, që po ashtu ishin anëtarë të Bordit të AKM-së. Dhe, nëse e lexoni faqen 1 dhe 2 dhe 3, shihet se ka këtu shumë fajësime të AKM-së, domethënë, tentohet të gjitha gjynahet të gjuhën në AKM, por nuk tregohet, nuk sqarohet ajo se fajtorë, pjesë e fajit janë edhe personat që sot i kemi. Pastaj unë pata reaguar atëherë, nuk është fshirë, siç duket AKP-ja gjithsesi tenton që të gjitha

gjynahet, po them edhe një herë t'i heqë nga vetja se kanë shumë gjynahe, vazhdojnë mënyrën e punës siç është bërë në AKM, disi kështu, befas edhe AKP-ja, kështu bënte edhe AKM-ja, dy ditë para kësaj seance mban një mbledhje atje dhe tenton që për disa kompetenca, për disa përzierje të konflikteve të interesave të veta, sidomos në 20% t'ia hedhë totalisht fajin Odës së Veçantë të Gjykatës Speciale ku, sidomos them me rastin tashmë shumë të njohur të punëtorëve të ish-fabrikës apo ndërmarrjes “Ramiz Sadiku” ku njerëzit presin sa e sa për të marrë 20% shin e tyre që u takon me ligj. Dhe, gjithmonë sipas tyre për shkak të përzierjeve politike nga personat që kanë influencë politike, çështja prolongohet, sidomos me lista ku manipulohen për interesa të grupeve të caktuara.

Unë siç e dini, e keni në transkriptin e 28 majit, e pata demantuar gjithë atë që AKP-ja fillimisht patë shkruar, ngjashëm e kemi edhe në faqen e dytë, janë disa të pa vërteta, atëherë pata pyet kush po e dezinformon opinionin, a është ministri i Punëve të Brendshme, zoti Zenun Pajaziti apo është Bordi i AKP- së i cili shtyp këtë broshurë me shumë të pavërteta, sidomos në rastin e, ku thuhet, djegies së dokumentacionit, për shkak se unë këtë pyetje, siç e dini e pata bërë në shtator të vitit 2008... domethënë për rastin i cili pat dalë në media, më 24 gusht djegia e Arkivit të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit dhe atëherë zoti ministër e keni në transkript e pat demantuar, pat thënë se një rast i tillë nuk është lajmëruar në polici, po e citoj dhe këtu AKP-ja përsëri insiston që të na shes këtë të pavërtetë, them ose opinionin e pat dezinformuar Zenun Pajaziti, ministër i Punëve të Brendshme ose Dino Hasanaj. Pastaj po them janë këtu shumë çështje të cilat janë të mjugulluara, rasti i Dino Hasanaj me IPKO-n ku tashti na del se nuk është më pronar i 5%shit në IPKO, domethënë se më parë ka qenë, derisa ishte edhe udhëheqës i AKP-së, që është konflikt edhe i drejtpërdrejtë i interesave.

Po them AKP-ja e vazhdon punën e AKM-së, sepse edhe këtu rastësisht, ashtu siç donte me AKM-n njerëz të cilët ishin drejtpërsëdrejti të involvuar me punë të rëndësishme të privatizimit, siç ishte rasti i ... Bajrushit që ishte drejtpërdrejt i involvuar në privatizim, në procesin e privatizimit të “Feronikelit” dhe shkon bëhet drejtori kryesor i ” Feronikelit” dhe tash bindëm mua se aty s'ka pasur kurdisje. Tashti e kemi, për shembull një rast tjetër po ashtu, befasishëm apo rastësisht, zoti Ekrem Tahiri, zëdhënësi i AKP-së bëhet pronar i Pia Arsolution dhe bëhet, domethënë, partner i Sachi & Sachi, i kësaj farë kompanisë shumë të përfolur me këtë, po them tenderin e marrë për përmirësimin e imazhit të Kosovës.

Përsëri, hajt bindëm mua se këtu është e rastit, se këtu nuk ka kurdisje të brendshme atje. Unë, megjithatë shpresoj se zoti ministër Ahmet Shala do t'i përmbahet fjalës së vet që e dha se do të mi jap ato shënimet lidhur me atë se si po vazhdohet me promovimin e Kosovës në tv-mediat ndërkombëtare dhe pres që të paktën kësaj here ai t'i mbajë fjalët e veta.

Po shkojmë tash te puna e privatizimit. Unë, siç e dini, po i përmend këtu nja dy ndërmarrje, kam bërë edhe pyetje parlamentare për të treguar se AKP-ja nuk është kah i kryen punët e veta, domethënë, ajo është vazhdimësi e AKM-së, përkundër faktit se paguhen, marrin paga astronomike atje, por detyrat nuk po i kryejnë dhe këtu nëse shihni faqe 72 për rastin e “Ballkanit” të Therandës edhe pse për këtë rast atje punëtorët ankohen për shkelje të procedurave apo të mosrespektimit të kushteve të tenderit, unë pata bërë disa herë pyetje parlamentare edhe më tutje asgjë nuk ndërmerret me rastin e “Ballkanit”. Janë prova të shumta ku pronari i ri nuk i ka respektuar premtimet, ku mjetet e investuara, mjetet e punës i blen nga kompania e vet që e ka në Turqi atje për shuma

minimale, i fryn faturat, domethënë, në vend se të investojë 6 milionë, ai i investon 600 milionë dhe janë shumë fakte të cilat punëtorët e "Ballkanit" të Suharekës i kanë dokumentuar, por këto prolongohen.

Po kthehem përsëri tash te 20% shi i "Ramiz Sadikut", unë këtu e kam një listë, siç e dini, ndërmarrjet të cilat janë privatizuar kanë pasur për detyrë që ta dorëzojnë listën e punëtorëve. Unë e kam një listë origjinale të cilën e kanë dorëzuar në vitin 2005 punëtorët – Sindikata e "Ramiz Sadikut" dhe më pastaj futen numër i konsiderueshëm i punëtorëve të cilët nuk kanë qenë apo nuk kanë të drejtë për 20%shin dhe sipas, gjithmonë, punëtorëve të "Ramiz Sadikut" aty....

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Vazhdojmë me deputetin e radhës, Naser Rugova, le të përgatitet Naim Rrustemi, i cili mund ta vazhdojë aty ku e lan Dritoni!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryesues!

Sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës po debatohet një raport i një institucioni shumë të rëndësishëm, i cili më nuk është AKM, por është AKP, është institucion i shtetit të Kosovës dhe ky Kuvend si organ më i lartë legjislativ i vendit tonë e ka nxjerr edhe Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në momentin kur ne si njerëz të zgjedhur të qytetarëve të Kosovës po diskutojmë për raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është për keqardhje që në këtë diskutim kaq të rëndësishëm për një institucion që menaxhon aktualisht dhe bën transaksione të shitjes së pasurisë kombëtare të Kosovës, është prezent vetëm një ministër nga Kabineti qeveritar, fatkeqësisht, këtu do të duhej të ishin njerëzit më kompetentë, bile 3-4 ministra që edhe Kryeministri që vërtet t'i dëgjojnë: vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet që i jep organi më i lartë legjislativ që i ka zgjedhur si ekzekutiv i vendit. Por, këtu edhe një herë po shihet që privatizimi është bërë çështje e pazareve të politikës, e pazareve private dhe e krimit të organizuar dhe e shpëlarjes së parave. Fatkeqësisht, krejt parametrat, krejt analizat dhe të gjitha statistikatat po e dëshmojnë që procesi i privatizimit në Kosovë, jo që nuk ndikoi në rritjen ekonomike, në hapjen e vendeve të reja të punës, po në njëfarë forme dekurajoi njerëzit, investitorët e huaj serioz dhe njerëzit tanë në radhë të parë dhe këtu janë bërë disa shitblerje si në mjegull, natën nëpër terr, pa transparencë konkrete dhe edhe ato ndërmarrje që dikur Kosova është krenuar me to, që janë të privatizuar me spinof special, tani janë para falimentimit të plotë.

AKP-ja duhet t'i jap disa përgjigje. Ku janë mjetet nga shitja e aseteve të pasurisë publike, të pasurisë kombëtare të Kosovës? Ku janë dhe me çfarë interesi dhe në çfarë afati kohor janë deponuar këto mjete, 400 milionë me një kamatë prej 0.10%, kjo vërtet është qesharake? Kush përfiton nga ato kamata dhe nga ai deponim dhe a jemi shtet apo nuk jemi shtet, a është ende AKM apo është AKP? Dhe, këtu duhet AKP-ja, por edhe institucionet përgjegjëse relevante të Republikës së Kosovës duhet ta gjejnë guximin dhe ta thonë fjalën e vet dhe të fillojnë për t' i menaxhuar këto mjete që janë të deponuara diku ku askush nuk e di. Edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta dijë adresën e saktë, sepse janë pasuri nacionale e popullit dhe e Republikës së Kosovës.

Te Oda e Veçantë, Komisioni ka bërë një rekomandim që të përshpejtojë procedurat e hartimit dhe dorëzimit në Kuvend të Ligjit për Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme. Ende Gjykata, kjo Odë e Veçantë e Gjykatës Supreme nuk e pranon në njëfarë forme

subjektivitetin juridik dhe institucional të AKP-së, por ende pretendon që me dokumentacion dhe me qasje të AKM-së të sillet ndaj shitjes së aseteve të pasurisë publike të Kosovës. Edhe këtu duhet t'iu japim përgjigje si Kuvend, por përgjegjësit e AKP-së, ku janë edhe përfaqësues të punëtorisë atje, duhet ta thonë fjalën e vet. Çka po ndodhë me sektorin minerar, me minierat dhe me mineralet e Kosovës, "Trepça" dhe një sërë minierave të tjera janë nën moratorium, janë ngri. Pse? Çka po bën AKP-ja, ndërmarrjet e Gjakovës, komplekset turistike në Brezovicë. Çka po ndodhë me këto pasuri kombëtare të Kosovës? Vallë a do të mund të bëhen këto transaksione kaq të rëndësishme deri në vitin 2012 dhe si do të shkojë procedura kur tani më nuk kemi spinof special. Vërtet është mjegull e madhe.

Deputeti Tali e potencoi çështjen e aseteve të shitura të ish- Kombinatit Ndërtimor "Ramiz Sadiku". 98 punëtorë janë jashtë listave, kemi biseduar me përfaqësuesit e Sindikatës dhe paramendoni, përgjegjës të lartë të AKP-së iu thonë: le të shkojë kjo listë e pa verifikuar, e falsifikuar dhe edhe në raste të tjera, sepse brenda jave do t'ia lëshojmë mjetet. AKP-ja qenka pronë private e 3-4 njerëzve aty që e kanë mbështetje politikën. Thjesht, AKP-ja duhet të japë përgjigje për këtë çështje, sepse është Rregullorja 2003/13 që në mënyrë decitive e saktëson se përfaqësues të punëtorëve janë ata që e dërgojnë listën në organet kompetente të ish- AKM-së dhe tani të AKP-së. Andaj, AKP-ja do të duhej që këtij institucioni të rëndësishëm, më të rëndësishëm të vendit, Kuvendit të Republikës së Kosovës, thjesht t'i japë përgjigjen në këto pyetje, sepse ne jemi përfaqësues të qytetarëve dhe nuk është vetëm shqetësimi i punëtorëve të "Ramiz Sadikut", plus 17 paga që nuk ua kanë paguar, por kemi edhe fakte tjera të ndërmarrjeve që punësoria kosovare brend rrugëve, kurse 20% shi që është mund shumëvjeçar i tyre thjesht prolongohet, shtyhet për interesa të çuditshme nganjëherë dhe ku jemi ne si Kuvend i Republikës së Kosovës, andaj dua të besoj që Kuvendi rekomandimet që dalin nga ky debat duhet të jenë një shenjë alarmi për AKP-n, sepse vërtet kështu më nuk shkohet? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi dhe le të përgatitet, diskutuesja e fundit e paraqitur deri më tani, Myrvete Pantina.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit edhe Dritonit po i them se e vazhdoi rrugën, e nisi e unë do t'ia vazhdoj, se me të vërtet është pikëpyetje e madhe si është e mundshme që punëtorët e "Ramiz Sadikut" të jenë peng i një liste, peng i një liste 98 veta që qartë dhe sipas fjalëve të sindikatës së "Ramiz Sadikut" del se është listë e manipuluar për interesa personale, individuale të njerëzve. Me fjalë të tjera, nuk po flasim këtu për interes, por po flasim për përfitime materiale, sepse pjesëmarrja në 20%shin e një organizate rezulton me para, rezulton me një shumë parash, a është 7.000 euro, 8.000, 10.000 euro, por rezulton me atë shumë parash. Dikush e ka thyer ligjin aty, dikush e ka thyer rregullën dhe nëse dikush e ka thye rregullën dikush duhet të paguajë për thyerje të rregullave, sepse nuk ke të drejtë të bësh lojë me 700 – 800 punëtorë apo 500 punëtorë sa do që janë të "Ramiz Sadikut" për shkak të lakmisë së individëve. Dhe, fenomenin e keq, duhet ta ndalim. Duhet ne të kërkojmë ta ndalim, por të kërkojnë edhe ata që janë përgjegjës për aplikimin, për sundimin e ligjit në Kosovë, sepse, një gjë po më duhet shumë shpesh ta përmend, nuk mund të flasim për demokraci pa sundim të ligjit. Ne e shohim listën, e ka shtirë dikush emrin, duhet paguar më vëlla për atë punë, sepse s'mund të jetë një punëtor i shkretë që i pret ato 7 – 8 mijë euro, 10 mijë euro peng i lakmisë tënde personale. Nëse ti s'ke moral, ndërgjegje për t'u ndalur, atëherë të ndal ligji.

Faleminderit, Driton, ma qite ndërmend, ky është edhe një argument i fuqishëm për të vendosur një rend dhe një kërkesë prej rregullave për punëtorët dhe për atë për çka ne jemi, për ta mbrojtur në njëfarë forme edhe të drejtën e qytetarit edhe interesin për të reflektuar të qytetarit. Secili mendim ndryshe, është jo i ndershëm, i pandershëm.

Po unë do t'i kthehem raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Edhe pse ka përpjekje të vazhdueshme që ne do të raportojmë se çka ka bërë AKM-ja, ne tash jemi AKP – AKM- n e kemi ndërrua një shkronjë, e kemi bërë të mirëbesimit, të privatizimit, jemi nën ombrellën e Kuvendit, Kuvendi na ka zgjedhur, por megjithatë disa përgjegjësi të individëve që ende punojnë në Agjencionin Kosovar të Privatizimit mbeten si përgjegjësi, sepse ky raport këtu po na tregon në shumë raste që ka mundësi, dhe vetë në raport është e shkruar. Për shembull, nëse shkojmë në faqen 88 kur flitet për një ndërmarrje, siç është ndërmarrja e “Llamkosit”. Ndërmarrja e “Llamkosit” dhe raporti po thotë ka indikacione se blerësi me qëllim ka dhënë hipotekë dhe obligime tjera mbi ndërmarrjen për ta ngarkuar ndërmarrjen me borxhe. Po me spinof special, monitorimi ka qenë obligim i AKM-së, monitorimi i investimeve, obligim. Dhe, me fjalë të tjera, sa për njohuri të qytetarëve dhe njohuri të gjithë prezentëve këtu, ndërmarrja e “Llamkosit” para se të privatizohet aty ka qenë një sasi e llamarinës që mund të vlerësohet mbi çmimin me të cilin është shitur Fabrika e Lllamarinës në Vushtrri dhe automatikisht me një logjikë të thjeshtë e ngre një pyetje: kush e ka monitoruar spinofin për shembull në këtë ndërmarrje, në “Llamkos”? Dikush ka bërë gabim. Dhe, nëse dikush ka bërë gabim, asgjë nuk ndodh, me fjalë të tjera ata që janë përgjegjës për sundimin e ligjit, janë ombrellë dhe mbrojtje e krimit. Me fjalë të tjera, AKP në një formë, ata që janë marrë me Agjencionin Kosovar të Privatizimit e dinë që financohet nga Komisioni Evropian, subvencionohet në pagesë. Komisioni Evropian parandë e mbledh nga qytetarët evropian. Sinqerisht të them unë nuk jam bukëpërmbysur kështu të them, por e kemi një obligim që ta mbrojmë edhe taksapaguesin evropian. Edhe AKP- ja disi lidhet me ta, EULEX-i gjithashtu mbulohet

nga taksapaguesi evropian. Nëse në AKP ndodh diçka që s’është e rregullt, që s’është e ndershme, që është me fjalë të tjera grabitje e pasurisë, a ka edhe tendencë për grabitje, atëherë edhe EULEX-i ka përgjegjësi nëse s’merr veprim. Sepse, nëse je përgjegjës për marrje të veprimit dhe nuk merr veprim atëherë ti je bashkëpjesëmarrës. Dhe nuk kisha pas qejf ta shoh EULEX-in si ombrellë të krimit, sepse nëse nuk merr veprim ai është ombrellë. Dhe, ashtu e kështu, nuk kemi parë asnjë element, asnjë fakt përpos që po e shohim me kerre nëpër Prishtinë dhe po e ngarkojnë trafikun aq shumë të kritikuar në Prishtinë.

E njëjta logjikë, ndodh edhe me “Ballkanin”. Dje, gjatë një bisede me disa nga punëtorët e “Ballkanit” të Suharekës thotë se investitori turk që e ka marrë “Ballkanin” në fakt e pasqyron që i ka fyer faturat 100 herë. Nuk mundesh ti të bësh investimin e 10.000 eurove, apo 1.000 eurove dhe ta deponosh si investim 100.000 euro, sepse kriter për privatizim ka qenë investimi, se është privatizuar me spinof special. E njëri prej kriterëve, përpos çmimit, që çmimi me spinof special nuk është kriteri i cili e përcakton fituesin, janë edhe investimet dhe trajtimet ndaj punëtorëve. Kështu që unë prapë, krejt ky raport një diçka po më sjell. Po më bie ndërmend diçka ku janë organet që duhet të merren me sundim të ligjit.

Mundet të shkruajë AKP- ja çfarëdo raportosh. Këto janë fjalë të AKP-ës çka po i them unë, se po thotë ka indikacione, ka edhe nëpër ndërmarrje tjera, nuk janë plotësuar kërkesat, nuk janë plotësuar zotimet që i kanë pasur për investime. Po dikush duhet të

paguajë për atë punë që po e bën. Nuk është pasuria që u bë me djersën e qytetarëve veç të hidhët qashtu poshtë, e ashtu poshtë e lartë ose me ta dhënë ty ndonjë donacion të vogël 10.000 euro, 15.000 euro dhe me luajt me ty dhe me humb me qindra milionë euro.

Me fjalë tjera, le të shërbejë ky diskutim imi si kërkesë, si kërkesë edhe ndaj policisë për krime ekonomike të Kosovës, të merret me raste të tilla, edhe ndaj EULEX-it për t' i kryer detyrat e veta që i kanë, sepse, ky raport rezulton në kërkesën për sundim të ligjit në AKP. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Diskutuesja e fundit është Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit! Faleminderit, zoti kryesues!

Raporti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën gusht 2008 – gusht 2009 është një raport gjithëpërfshirës, por u në do t' i cek disa shqetësime të mia lidhur me këtë raport dhe me procesin e privatizimit në Kosovë. Në radhë të parë, dua të theksoj se edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë, por ende është shumë shqetësues fakti se pse nuk u bë pranim- dorëzimi zyrtar i dokumentacionit nga AKM-ja, domethënë, pasardhësit të tij ose AKP-së, për shkak të mosrespektimit të se cilës procedurë AKP është e mangët me material arkivor dhe me informatat tjera? Edhe pse sipas skenarit të bartjes së kompetencave kjo është dashur të kryhet në qershor të vitit 2008, por deri në ditët e sotme nuk është dhënë ende asnjë sqarim dhe nuk duhet të kënaqemi me këtë heshtje. Edhe më tutje vazhdon të na brengos fati i mjeteve të Fondit të Mirëbesimit të AKP-së.

Nuk mjafton vetëm të kërkohet garancë nga Banka Qendrore e Kosovës për sigurimin e këtyre mjeteve, por duhet të insistohet në kthimin e tyre në Kosovë në dobi të ekonomisë sonë.

Një element tjetër shqetësues lidhur me raportin është moskryerja e obligimeve ndaj punëtorëve. U cek edhe më herët edhe nga kolegët tjerë, është fjala për 20%shin nga shitja e ndërmarrjeve. Në këtë raport ceket se përfitimet e punëtorëve nga procesi i privatizimit kanë arritur shumë prej 76 milionë euro, prej të cilave vetëm 16 milionë euro u janë paguar punëtorëve përmes Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Andaj, parashtrohet pyetja pse zvarriten këto pagesa kur dihet se ato u takojnë punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara. Lidhur me këtë, mendoj se Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme duhet të luajë rolin e vet, sepse jam e informuar nga mediat se Oda e Veçantë ka marrë vendim për shpërndarjen e mjeteve ndaj përfituesve për ato ndërmarrje që janë shitur në mandatin e AKM-së, ndërsa për listat tjera të përgatitura nga AKP-ja, Oda e Veçantë ende nuk ka marrë asnjë vendim.

Një problem tjetër që e ngarkon procesin e privatizimit në Kosovë janë shitja e ndërmarrjeve shoqërore nga AKP-ja, të cilat ndërmarrje janë të uzurpuara nga persona të ndryshëm dhe problemi paraqitet pas shitjes së këtyre ndërmarrjeve pasi që blerësve të rinj u mbetet problemi për largimin e uzurpatorëve, gjë që bëhet me vendim të gjykatës, andaj do të ishte më efikase që ndërmarrjet shoqërore, më parë të lirohen nga uzurpatorët e pastaj ato të qiten në shitje. Pyetja është: Pse AKP-ja nuk e ka bërë deri më tani këtë praktikë? Sipas mendimit tim, një element tjetër shqetësues për procesin e privatizimit është pjesëmarrja apo interesimi shumë i vogël i diasporës kosovare për blerjen e ndërmarrjeve të privatizuara shoqërore në Kosovë. Athua pse mungon ky interesim?

Dhe, në fund dua të cek se ndërmarrjet që janë privatizuar apo vërtet ndërmarrjet që kanë dështuar në privatizim, nuk duhet lënë mëshirës së kohës që ato të shkatërrohen, konkretisht “Llamkosi”, por duhet bërë një zgjidhje tjetër, të gjendet një zgjidhje sa më e shpejtë. Ato të shkojnë në ritenderim, apo t’u jepen operatorëve të interesuar për t’i aktivizuar këto ndërmarrje për një periudhë të caktuar kohore, e operatorë të tillë ka mjaft. Jemi të informuar për ndërmarrjen “Llamkos”. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në vazhdim, meqë nuk ka diskutues tjerë të paraqitur, ju ftoj që të miratojmë Raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën gusht 2008 – gusht 2009 me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Paraprakisht konstatoj se në sallë janë 63 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim.

Regjia, votojmë tash.

Konstatoj se me 40 vota “për”, 14 “kundër” dhe 10 abstenime u aprovua raporti i AKP-së për periudhën gusht 2008 – gusht 2009.

Ju faleminderit! Me kaq i përfundojmë punimet e seancës së sotme. Mirë u pafshim në seancën e radhës!

Përgatiti: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale